

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7692 E diel 28 Tetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Vështirë të gjendet në historinë e 70 viteve të fundit një rast tjetër kur kryeqeveritari dhe trajneri i Kombëtares së një vendi të jenë njëherazi në ...  
Vijon në faqen 21

Nga JORGJI KOTE

Merkel dhe Lëv drejt "skualifikimit"?



Opinion

Ditës

Para një jave, një njohës i mirë i mekanizmit të pushtetit dhe personazh i dorës së parë në këto 28 vjet tranzicion me thoshte se, Fatmir Xhafaj do të ...  
Vijon në faqen 22

Nga DRITAN HILA

Arsyeja e vërtetë e shkarkimit të Xhafajt dhe emërimit të Lleshit



Pronarët/ Emrat në Tiranë dhe Elbasan

## Zonat informale, 290 familjet që marrin paratë për kompensimin

Legalizimet, familjet që përfitojnë nga fondi financiar. Lekët në llogari bankare

Agjencia e Trajtimit të Pronave (ATP) njofton se ka përfunduar procesin e shqyrtimit për 290 (dyqind e nëntëdhjetë) kërkesa, të paraqitura nga subjektet përfitues, pronarë të pasurive të paluajtshme, pronë private, të prekura nga ndërtimet informale, që përfitojnë deri më tani ...  
Në faqen 8-9

## LARGOHET MINISTRI I BRENSHEM: SULMET E OPOZITES, SHENJE E DEGRADIMIT

# DOREHIQET FATMIR XHAFAJ, PRAPASKENAT E LARGIMIT

Basha: Nisi shkërmoqja e qeverisë së krimit. Berisha: Rama shiti Xhafajn për Gjushin. Kryeministri emëron ministër të ri Sandër Lleshin. Pritet dekreti



(Në foto) Kryeministri Edi Rama dhe ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj, gjatë një seance parlamentare

INTERVISTA

Nishani: Ka nisur demontimi i piramidës së qeverisë "Rama"

Në faqen 5

KORRUPSIONI

Merrte rryshfet për një vend pune, prangoset zyrtarja në Berat

Në faqen 7

TIRANE

Goditet baza e prostitucionit, kapet menaxherja e qendrës së masazhit

Në faqen 6

KULTURE

Rrëfimi i "Azizit", një film i veçantë për të shkuarën dhe të tashmen

Në faqen 12

"I FORTI I SHKODRES"



Kapet në Spanjë me armë Enver Bajri, i dënuari në Itali me 6 vite burg

Në faqen 7

MUSAO

Memoria historike përmend Shkodrën, Drishtin apo Metropolinë e Durrësit

## Ku gjenden bibliotekat e vjetra në Shqipëri?

Në brendësi: Historia e Çamërisë përmes letërsisë, nga Ben Andoni

NGA GJON MARKU

Tradita letrare gojore, e cila është e lashtë te çdo popull dhe që lindi atëherë kur njeriu u bë i vetëdijshëm për veprimtarinë e vet, u pasua nga një mënyrë tjetër, nga një traditë e re e krijimtarisë dhe ekzistimit të fjalës



artistike dhe e komunikimit letrar - shkrimi. Fillimet e para të tij i gjejmë afro 4000 vjet para erës së re (para Krishtit). Por rrënjët dhe fillimet duhen kërkuar më herët se të dhënat dokumentare që disponojmë deri më sot. Vepra e parë letrare e botës që ne ....

Suplement

## DOREHEQJA EMERIMI

Kryeministri prezanton këshilltarin për mbrojtjen: Kadare e donte president

# Rama: Xhafaj ka kontribut të çmuar, tani "traseja" është e shtruar

*"Po gjuajte shtëpinë me gur, del jashtë"*

Kryeministri Edi Rama pas pranimi të dorëheqjes së Fatmir Xhafaj nga posti i ministrit të Brendshëm, inkurajoi ministrin e ri për arritjen e rezultateve pozitive në krye të dikasterit, pasi sipas tij, "traseja" është e shtruar. "Pranova dorëheqjen e ministrit Xhafaj, të cilin e falënderoj për kontributin e çmuar. Edi Rama prezantoi edhe emrin e këshilltarit për mbrojtjen. Ai do të jetë gjeneral Sandër Lleshi, i cili u shkarkua nga detyra nga ish-ministri i Mbrojtjes, Arben Imami. Lleshi është një nga ushtaraktë e njohur, ndërsa emri i tij u propozua nga Rama për president një vit më parë, i sugjeruar nga Ismail Kadare. "Emrin e Sandër Lleshit e kam dëgjuar për herë të parë nga Ismail Kadare, i cili u sugjeroi palëve si një kandidat të spikatur për President të Republikës një vit më parë. Më vonë munda ta çmoj përmes mediave kur denoncoi publikisht rrënimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe degradimin e rëndë të drejtimt të ushtrisë sonë. Dhe njohja nga afër erdhi kur pas zgjedhjeve, e thirra për ta dëgjuar lidhur me gjithë çka kishte denoncuar publikisht, si edhe me idetë e tij për të ardhmen e dikasterit qendror të mbrojtjes si edhe të vetë Forcave të Armatosura natyrisht. Pas disa komunikimesh kuptova, besoj, arsyet pse shkrimtari i shquar e kishte menduar si president të denjë për vendin këtë gjeneral të panjohur. I edukuar në perëndim, njohës i mirë i historisë dhe bartës i modestisë intelektuale që karakterizon të diturit, zotëruar i thellë i fushës jo vetëm nga librat, por edhe nga rugëtimi i një karriere të gjatë - nisur si fëmijë i një familjeje të varfër nga veriu në derën e shkollës së mesme ushtarake "Skënderbej" dhe ndërprerë brutalisht në



Kryeministri Edi Rama

### DEKLARATA

Kryeministri inkurajoi ministrin e ri për arritjen e rezultateve pozitive në krye të dikasterit, pasi sipas tij, "traseja" është e shtruar. "Pranova dorëheqjen e ministrit Xhafaj, të cilin e falënderoj për kontributin e çmuar. Gjeneral Sandër Lleshi do të sjellë një energji të re pozitive në krye të Punëve të Brendshme", tha z.Rama.

## Pse e anuloi konferencën ish-ministri

### Rikthehet Sajmir Tahiri: Unë, "Zëri i Popullit"

Ish-ministri i Brendshëm, Sajmir Tahiri ka dalë jashtë skenës politike pas heqjes së të gjitha funksioneve si në Partinë Socialiste, ashtu edhe në parlament. Por, me sa duket Tahiri nuk dëshiron të mbetet jashtë jetës publike. Mësohet se ish-ministri do të rrihapë "Zërin e Popullit". Nuk bëhet fjalë për gazetën e famshme, por një portal me këtë emër. Ndërkohë, vetë Tahiri konfirmoi dje për "News 24" vendimin e

tij për të hapur këtë ueb në emrin e tij. Ndërsa ndodhet nën akuzë nga prokuroria, Tahiri me sa duket ka vendosur një tjetër lloj rikthimi në jetën publike të vendit, nëpërmjet një medie. Ish-ministri i Brendshëm, njëherësh ish-deputeti i PS-së, Sajmir Tahiri dje anuloi konferencën e njoftuar për paraditen e djeshme. Njoftimi dy ditë më parë nga ana Tahirit u shoqërua dje në mëngjes me dorëheqjen e Fatmir Xhafaj nga posti i ministrit të

Brendshëm. I kontaktuar nga "Panorama Online", Sajmir Tahiri konfirmoi anulimin e konferencës për shtyp të programuar për ditën e djeshme në hotel "Rogner". Por i pyetur nëse kjo kishte të bënte me zhvillimet e fundit dhe dorëheqjen e Fatmir Xhafaj nga posti i ministrit të Brendshëm, ish-deputeti i PS-së tha se ky vendim i tij nuk kishte lidhje me dorëheqjen e pasardhësit të tij.

shkoja prapë në plazh nudo. Nuk shkoja dot më, se mbaroi. Por ka edhe të tjera, diskutojmë me me njëri-tjetrin dhe kemi ndonjë shok që thotë jam njeri i lirë. Jo mo se nuk je njeri i lirë, je i lirë ta thuash këtu dhe ta diskutojmë këtu, por nuk je i lirë të dalësh atje e të gjuash me gurë shtëpisë ku jemi bashkë se nuk ka kuptim. Nëse do të dalësh t'i gjuash me gurë shtëpisë, ik se nuk je pjesë e shtëpisë", deklaroi z.Rama. Po dje kryeministri

pozicionin e zëvendës Sh-tabit të Përgjithshëm nga arroganca e injorancës së pushtetit në ikje - Sandër Lleshi ka pranuar të jetë këshilltari im për mbrojtjen në Kryeministri", deklaroi z.Rama.

### TAKIMI

Kryeministri Edi Rama ishte dje në Lushnjë në kuadër të fushatës së anëtarësimeve të reja në Partinë Socialiste. Edhe pse në mëngjes njoftoi dorëheqjen e ministrit të

Brendshëm, Fatmir Xhafaj, në të dyja aktivitetet që ishte dje në Lushnjë, Rama nuk e komentoj drejtpërdrejt këtë zhvillim të papritur. Ndërkohë që anëtarëve të rinj socialistë u përcollti mesazhin e tij për lirinë. Çfarë është liria kur je brenda PS-së? Kryeministri u tha të pranishmëve se kur të hyni në parti, gjërat janë ndryshe. "Kur hyn në një parti, nuk i bën do të gjitha. Unë që kur hyra në parti, hoqa dorë nga ideja që mund të



## Mediat botërore shkruajnë për dorëheqjen e Xhafaj: Presim shpjegimin e Ramës

Gazeta "The New York Times", "Washington Post" dhe "DW" i kanë dedikuar një artikull dorëheqjes së ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj. Mediat botërore shkruajnë se deri tani nuk ka pasur asnjë lloj shpjegimi nga ana e kryeministrit Edi Rama. Mediat më të mëdha në botë kanë nisur të shkruajnë pasi ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj dha dorëheqjen. "The New York Times" dhe "Washington Post" kanë publikuar një artikull nga "AP" ku shprehen se kryeministri Edi Rama e ka pranuar dorëheqjen e Xhafajit pa asnjë lloj shpjegimi. "Kryeministri shqiptar tha se ministri i Brendshëm i vendit ka dhënë dorëheqjen. Duke shkruar në rrjetet sociale, kryeministri Edi Rama tha se ka pranuar dorëheqjen e ministrit Xhafaj, pa dhënë asnjë shpjegim. Më pas Rama nominoi Sandër Lleshin, një ish-zyrtar ushtarak, për postin në fjalë. Rama tha se Lleshi do të sjellë energji pozitive. Lufta kundër krimit të organizuar, trafikut të drogës dhe korrupsionit janë prioritetet kryesore për Shqipërinë, e cila shpreson që të nisë negociatat e plota me BE-në gjatë vitit tjetër. Xhafaj pritet të lëshojë një deklaratë në vazhdim", - shkruan ato ndër rreshta. Ndërsa "Deutsche Welle" shkruan se Xhafaj ishte një nga arkitektët e reformës në Drejtësi. Më pas shtron pikëpyetjen "Pse dha dorëheqjen?".

takoi në Lushnjë gra e vajza me të cilat foli për ligjin e heqjes së lojërave të fatit. Ai theksoi idenë e kthimit të parasë brenda familjeve për konsum të shëndetshëm, duke larguar burrat e djemtë nga pikat e basteve. "Ne arritëm që t'ia dalim aty ku në fakt u thyem disa vite më parë si pasojë e një presioni të jashtëzakonshëm nga kjo industri mbi deputetët dhe nuk i patëm dot votat për të mbyllur kazi-

notë elektronike. Sidoqoftë, u bë një kompromis që nuk ishte ideal për të mbyllur kazinot në Shqipëri në 31 dhjetor dhe që atëherë deri më sot kemi parë dy anë të një medaljeje për të cilën hymë në këtë betejë. Kemi formalizuar sektorin, kemi marrë dyfishin e taksave që merrnin më parë. Nuk janë pak të ardhurat në buxhetin e shtetit nga këto taksa. Është më e rëndë plaga e anës së medaljes", tha z.Rama.





Mesazhi i ministrit pas dorëheqjes: Shërbeva me pasion, arritëm sfida të pamundura

# Ikën Xhafaj, Rama emëron Sandër Lleshin ministër të Brendshëm

*Ministri i Brendshëm: Largohe me vullnetin tim*

Valentina Madani

**K**ryeministri Edi Rama në mënyrë të papritur mëngjesin e djeshëm njoftoi dorëheqjen e ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj. Përmes një postimi në rrjetet sociale, z.Rama bëri të ditur se ka pranuar dorëheqjen e Xhafajt, duke e falënderuar atë për kontributin në krye të dikasterit më të rëndësishëm të vendit. Kreu i qeverisë njoftoi gjithashtu edhe emrin e ministrit të ri të Brendshëm, i cili vjen nga radhët e Forcave të Armatosura dhe mban gradën "gjeneral". Pasardhësi i Fatmir Xhafajt do të jetë gjeneral Sandër Lleshi, që aktualisht mban detyrën e këshilltarit për sigurinë pranë kryeministrit. Ministri i Brendshëm në detyrë, Fatmir Xhafaj mbërriti dje në zyrën e tij pak çaste pas dorëheqjes nga posti i ministrit të Brendshëm. Xhafaj zhvilloi një takim me zv.ministrat, këshilltarët dhe bashkëpunëtorët. Në një koment të shkurtër për mediat teksa hynte në Ministrinë e Brendshme, Xhafaj falënderoi gazetarët, por edhe familjen e tij. "Hera e parë që vij kaq me vonesë, pas një mbledhjeje shumë të këndshme me bashkëshorten, familjen time dhe me mbësën. Të dytë që takoj jeni ju dhe jam shumë i lumtur që ju takoj, pasi kemi bashkëpunuar mirë, shumë mirë dhe jam mirënjohës për gjithë çfarë kemi bërë së bashku", u shpreh z.Xhafaj. Në një reagim me shkrim të bërë më herët, ai shprehet se i paraqiti dorëheqjen kryeministrit me vullnetin e tij duke e falënderuar për besimin e dhënë. "Pas më shumë se 1 viti në krye të Ministrisë së Brendshme, me vullnetin tim, i kam paraqitur kryeministrit Edi Rama dorëheqjen time si ministër i Brendshëm, duke e falënderuar për besimin e



**FATMIR XHAFAJ**

"Opozita me komentet për dorëheqjen time konfirmojnë edhe një herë degradimin e saj politik. Fatkeqësi për ata vetë, por edhe për qytetarët. I sfidoj ata e cilindo, tanimë që nuk do të jem ministër të provojnë akuzat e bëra ndaj meje si ministër. Përbuz shpifjet e komentet neveritëse të kujtdo që nuk mund të kuptojë dot se ka edhe njerëz në politikë, që mund të jenë të lirë dhe vetvetja në çfarë mendojnë e çfarë bëjnë", tha Xhafaj.

## Sandër Lleshi, gjenerali i emëruar ministër i Brendshëm

Gjenerali Sandër Lleshi është emri që do të zëvendësojë Fatmir Xhafajin në postin e ministrit të Brendshëm. Aktualisht ministri i ri i Brendshëm mban postin e këshilltarit të kryeministrit Rama për çështjet e sigurisë. Kryeministri i ka propozuar Presidentit të Republikës emërimin e gjeneral Sandër Lleshit si ministër të Brendshëm, pas dorëheqjes së Fatmir Xhafajt. Ish-ushtarak në pension, Lleshi ka mbajtur që prej vitit 2013, kur Rama erdhi në pushtet, detyrën e këshilltarit të kryeministrit për çështjet e Sigurisë. Më herët karriera e tij ka qenë tërësisht dedikuar Forcave të Armatosura, ku si post më të lartë ka pasur atë të numrit dy të Ushtrisë, si zv.shëf i Shtabit të Përgjithshëm, detyrë në të cilën u emërua nga ish-presidenti Bamir Topi.

### KUSH ËSHTË SANDËR LLESHI

- Në periudhën 1996-2000, gjeneral Lleshi ka qenë komandant i Kurseve në Akademinë e Mbrojtjes në Tiranë dhe më pas, për tri vite të tjera ishte komandant i Akademisë Ushtarake "Skënderbej".
- Në vitet 2003-2006 ka shërbyer si atashë i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë në Gjermani. Sa i takon arsimin të tij në fushën ushtarake, fillon në periudhën 1978-1985 kur ka kryer Shkollën e Mesme Ushtarake "Skënderbej" dhe Akademinë Ushtarake.
- Nga viti 1994 deri në 1999 ka kryer një sërë kursesh, si ai i gjuhës gjermane në Akademinë e Mbrojtjes Kombëtare në Vjenë (Austri), kurs i avancuar i gjuhës gjermane në Institutin Federal të Gjuhëve (Bundesprachenamt) në Gjermani; kurs i komandantit të Batalionit në Shkollën e Artilerisë Kundërajrore në Rendsburg, Gjermani; kurs i Shtabit të Përgjithshëm në Akademinë e Drejtimit në Hamburg, Gjermani dhe kurs i Sigurisë Europiane në Akademinë e Drejtimit në Hamburg, Gjermani.
- Në 2008-n, gjeneral Lleshi ka përfunduar Seminarin e Lartë Ekzekutiv në Qendrën për Studime të Sigurisë Europiane, George C. Marshall në Garmisch-Partenkirchen, Gjermani; ndërsa në 2011-ën përfundoi Kursin e Lartë Ndërkombëtar për Menaxhimin e Mbrojtjes në Shkollën Pasuniversitare të Marinës në Monterey, Kalifornia, SHBA.

### SHKURT

## Meta firmos dekretin, Xhafaj zyrtarisht jashtë qeverisë

Presidenti i Republikës, Ilir Meta firmosi dje dekretin për shkarkimin e Fatmir Xhafajt nga detyra e ministrit të Brendshëm. Ky dekret sjell edhe largimin zyrtar të Xhafajt nga dikasteri i Brendshëm. Meta ende nuk e ka firmosur dekretimin e Sandër Lleshit si pasues i Xhafajt në Ministrinë e Brendshme. Kryeministri Edi Rama njoftoi sot dorëheqjen e Xhafajt nga detyra si ministër i Brendshëm, njëkohësisht me lajmin e emërimit në këtë post të Sandër Lleshit. Sipas Kushtetutës, ministri emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës, me propozim të kryeministrit, brenda 7 ditëve. Më tej dekreti i presidentit shqyrtohet brenda 10 ditëve nga Kuvendi.

## Kur u dorëhoq Xhafaj, si u ndryshua mesazhi në "Facebook"

Kryeministri Edi Rama njoftoi mëngjesin e djeshëm nëpërmjet një statusi në "Twitter" se pranoi dorëheqjen e ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj. Por në fakt, dorëheqjen Xhafaj ia ka dorëzuar kreut të qeverisë që ditën e enjte dhe këtë e provon një status i hedhur në logarinë e Ministrisë së Brendshme në "Facebook". Një postim që ndoshta jo të gjithë e kanë parë, pasi është ndërruar 2 minuta pasi është bërë. Në tekstin e parë thuhet se Xhafaj i ka paraqitur që të enjten dorëheqjen Ramës. Ajo ditë korrespondon me publikimin e bisedave në telefon të kryebashkiakut të Durrësit, Vangjush Dako me anëtarë të bandës së Avdyllajve.

dhënë me emërimin në këtë detyrë të rëndësishme. Erdha në këtë detyrë për një mision të

veshtirë, shërbeva me pasion, me modesti dhe me devotshmëri në shërbim të shtetit, të ligjit dhe të

qytetarëve. Sfidat kanë qenë tepër të mëdha, por jam krenar se në krye të një ekipi me integritet e përkushtim në Ministrinë e Brendshme dhe Policinë e Shtetit, kemi mundur të arrijmë suksese shumë të rëndësishme në forcimin e rendit dhe sigurisë në vend, disa prej tyre të konsideruara të pamundura për vite të tëra. Falënderoj të gjithë ekipin, kolegët, miqtë e mi dhe veçanërisht familjen time, si dhe të gjithë ata që më vlerësuan, besuan dhe më mbështetën gjatë gjithë kësaj periudhe. Vlerësim dhe mirënjohje nga zemra për të gjithë ata burra dhe gra në uniformë, për gjithçka bënë gjatë kësaj periudhe në luftë me krimin dhe paligjshmërinë. Një falënderim i veçantë edhe për partnerët vendës dhe ata të huaj, agjencitë ligjzbatuese vendëse e ndërkombëtare, mbështetja e të cilëve ka qenë një inkurajim shumë i rëndësishëm", deklaroi z.Xhafaj. Fatmir Xhafaj pasoi në këtë detyrë Saimir Tahirin. Ai ka qenë vazhdimisht i sulmuar nga opozita, sidomos pas publikimit të një audio-përgjimi që implikon vëllain e tij dhe që njihet si çështja "Babale". Xhafaj ka mohuar në vazhdimësi akuzat, duke i konsideruar politike dhe hedhje balte mbi policinë.

## DORËHEQJA REAGIMET

Kreu i PD-së: Fillimi i shkërmoqjes së bashkëqeverisjes së Edi Ramës me krimin

# Largimi i Xhafajt, Basha: Hap i rëndësishëm për pastrimin e politikës

Berisha: Rama shiti Xhafajn për të shpëtuar Dakon

Valentina Madani

Për kreun e opozitës, Lulzim Basha, largimi i Fatmir Xhafajt nga Ministria e Brendshme ka qenë një kërkesë e vazhdueshme. Basha e konsideroi dje një fitore të opozitës kundër krimit dhe një hap të rëndësishëm në luftën e opozitës për të pastruar politikën nga krimi. "Me Fatmir Xhafajn krimi vuri nën kontroll të plotë policinë dhe prokurorinë, por largimi i tij është vetëm fillimi i shkërmoqjes së bashkëqeverisjes së Edi Ramës me krimin. Beteja për çlirimin e politikës, ekonomisë dhe shoqërisë nga krimi do të vazhdojë deri në fitore. Shqiptarët meritojnë një qeveri që punon për njerëzit", deklaroi z.Basha. Opozita ka bërë akuzat të rënda në vazhdimësi ndaj Xhafajt, të cilin e akuzon për mbrojtjen e vëllait të tij dhe për marrjen në dorë të sistemit të drejtësisë. Dorëheqjen e ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj, e komentoi dje edhe ish-kryeministri Sali Berisha, sipas të cilit Edi Rama shiti Fatmir Xhafajn për Vangjush Dakon. "Edvini, kreu i meduzës, mafies shtetërore më të rrezikshme të Europës, shiti Xhafajn për të shpëtuar Gjushin dhe lëkurën e tij", shkruan Berisha, duke nënkuptuar kreun e Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako. Sipas tij, pas një beteje të furishme, opozita shqiptare ia doli t'i japë një goditje të merituar familjes mafioze Xhafaj, "Agron/Geroni në burg dhe aty e ka vendin Fatzi Xhafaj, njeriu që futi në polici të gjitha metodat e punës së mafies së policisë sekrete hoxhiste për të mbrojtur lëkurën dhe karigen e tij", shprehet z.Berisha. Ish-kryeministri ka bindjen se opozita ia doli, por ai beson se shtylla kryesore e botës së mafies është vetë kryeministri Rama. "Në një aspekt opozita ia doli, por shtylla kryesore e botës së mafies, krimi të organizuar, korrupsionit, kreu i meduzës në Shqipëri është Edvin



Kreu i opozitës, Lulzim Basha

### LULZIM BASHA

Kreu i PD publikoi dje një video që akuzon Vangjush Dako për lidhjet e tij me bandën e Shijakut, të arrestuar javën e kaluar për trafik droge. Sipas Bashës, restoranti "Pista" në Durrës, në pronësi të grupit të Avdyllave është ndërtuar me lejen e Vangjush Dakos. Basha thotë në video se Dako e ka lënë Durrësin në dorën e krimit të organizuar si shpërbllim për blejen e votave për pushtetin e Edi Ramës.

## "Dorëheqja, ç'ka thënë opozita, po del e vërtetë"

Bylykbashi: Rama është "peshkaqeni" që po qelb të gjithë tepsinë

Deputeti i PD-së, Oerd Bylykbashi, e konsideron largimin e Fatmir Xhafajt si fillimin e shkërmoqjes së qeverisë "Rama". Bylykbashi e lidh dorëheqjen e Fatmir Xhafajt me akuzat e opozitës se i vëllai është i përfshirë në trafik droge dhe ish-ministri i Brendshëm e ka mbrojtur atë. "Në fillim ikën Habilajt me gjithë Tahir, më pas Bajrot, më pas Avdylla-

jt?, tani Xhafajt. Ç'ka thënë opozita, po del e vërtetë. Aleanca e qelbësirave, siç e quajti një ideolog i saj dikur në 2013, po shkërmoqet në mes të panikut. Sa shkel njëri syrin dhe njofton konferencë shtypi, apo thotë shprehje me kod në TV dhe ja ku ikën ministër apo deputet. ?Dhe ky është vetëm fillimi i shkërmoqjes. Prisi të shihni të radhës", shkruan Bylykbashi. Më tej deputeti demokrat sh-

ton: "Deri më sot po binin në rrjetë 'peshq të vegjël' të qelbur. Sot ra një 'peshk i madh'. ?Por siç e thotë një shprehje e vjetër durrsake, 'Kur man erë bishti i peshkut, koka është qelb kahone!' Dhe durrsakët këto historitë me 'peshq' i njohin mirë. Edi Rama është 'peshkaqeni' që po qelb të gjithë tepsinë. Duhet hedhur me gjithë tepsia sa nuk është qelb shtëpia përfundimist!"

Kristaq Rama, i cili në një moment kritik për veten e tij sakrifikoi Xhafajn për Gjushin dhe vendosi në krye të ministrisë një vasal të tij", shprehet z.Berisha. Ish-kryeministri shkruan ndër të tjera se po qarkullojnë zëra se Xhafaj është regjistruar në një aferë rozë, por e gjitha gjithë kjo, sipas tij është shpifje për të hequr vëmendjen nga shkaku i vërtetë i largimit të tij. "Ajo që bie në sy është se krerët e familjeve mafioze Rama-Gjushi, për të zhdukur gjurmët e shkakut të vërtetë të eliminimit të

Xhafajt, duan ta paraqesin atë në mënyrën më të pafytyrë dhe amoralë si viktimit të krimit të vetë të pasionit. Kështu, pasi nga kryshpella e mafies të kreu të meduzës u përhapën lajmet për një aferë rozë të regjistruar të Xhafajt dhe për ta bërë të besueshme shpifjen e ulët të kuzhinës së tij mafioze, Rama shprehet në Lushnjë në takim me gratë dhe vajzat se: "Kujdes Rama anëtarësohe në Partinë Socialiste, ka kushte të vështira. Unë hoqa dorë nga e dala nudo. Bëni logaritë nëse hiqni dot dorë pasi të hyni në PS", shprehet

z.Berisha. Sipas tij, "me këtë deklaratë, me këtë trillim të ulët grotesk dhe të neveritshëm, kryebosi Edvin Kristaq Rama dëshmon se njëlloj si në bodrumet e mafies, ai është i aftë të përdorë çdo mjet për të propozuar me çdo kusht edhe të gjallë rivalin. Këto zhvillime janë një thirrje për ndërgjegjen njerëzore të çdo shqiptari, të krrejme një minutë e më parë nga strofllat e pushtetit mafioz kryemafiozin Edvin Kristaq Rama dhe bosët e tjerë mafiozë të regjimit të kaktokrakisë (dmth., me të këqijve)!"



### PETRIT VASILJ

"Po ky kryeministër i shpëlarë politikisht dhe moralisht, pa të shkuar dhe pa asnjë të ardhme ç'bën akoma në atë zyrë?! Apo sigurisht, zvarritet edhe ca për të ikur turpshëm dhe pa asnjë dinjitet siç vetëm ai mund të ikë", tha kreu i deputetëve të LSI.

### SHKURT

## LSI: Dorëheqja e Xhafajt, si parathënie e rënies së Ramës

Nënkryetari i LSI, Luan Rama, e komentoi dje dorëheqjen e Fatmir Xhafajt si një "parathënie" të rënies së kryeministrit Rama. Sipas tij, dorëheqja e Xhafajt nuk e shpëton dot qeverinë dhe qeverisjen tërësisht të kriminalizuar. "Dorëheqja si institucion në politikën shqiptare, për fat të keq vazhdon të mbetet episod, pa mundur të bëhet dot një fenomen i qasjes së përgjegjshme, të paktën në dimensionet e skrupujve moralë. Por gjithsesi, edhe ky episod thotë shumë më tepër nga sa është 'lexuar' deri tani", shkruan Rama, ndërsa shton se "me largimin e Fatmir Xhafajt krijohet iluzioni sikur qeveria shpëtoi më në fund nga 'targeti' i goditjes, por në fakt është e kundërta!", deklaroi z.Luan Rama.

## Largimi i Xhafajt, Dule: Stuhi të reja po vijnë

Nga Korça, kreu i PBDNJ, Vangjel Dule, teksa komentoi dorëheqjen e papritur të ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj paralajmëroi se "stuhi të reja po vijnë". "Duke mos pasur dijeni për arsyet e dorëheqjes, do thosha se është paralajmërim stuhish të reja furtune, që do i japë fund kësaj historie qeverisjeje", u shpreh z.Dule. Kreu i PBDNJ, i pyetur se a po shkon vendi drejt zgjedhjeve të parakohshme, u përgjigj: "Kjo do të thotë se duhet të jemi të ndërgjegjshëm. Jeta politike i ngjan një moçali më kuptimin denotativ dhe konotativ. Strukturat shtetërore të destinuara nga Kushtetuta dhe ligjet për t'u vënë fre këtyre fenomeneve janë në status të kapur. Duhet vënë në funksion sinjalet e alarmit".





Ish-presidenti: I kja e Xhafajt e kërkuar, Lleshi ekstremist politik, ka fyer Kushtetutën

# Nishani: Rama të ikë, t'u hapë rrugë njerëzve të përgjegjshëm

## "Presion qytetar, nisi demontimi i piramidës"

Ish-presidenti Bujar Nishani tregon një tjetër version se çfarë ka ndodhur brenda PS-së, që solli dorëheqjen e Fatmir Xhafajt. Duke iu referuar aludimeve për një luftë të brendshme në PS, ai tha në emisionin "Kjo javë" në "News 24" se në bazën e PS kanë qarkulluar zëra se Xhafaj, Tahiri dhe të tjerë po komplotojnë kundër Edi Ramës. Ai u shpreh se kjo është një mendësi e përhapur nga Rama, me qëllim justifikimin e shkarkimit. Nishani tregoi edhe mënyrën e vetme, sipas tij, që situata të normalizohet. "Ka rreth dy muaj që në bazën socialiste po flitet që Xhafaj, Tahiri e të tjerë po komplotojnë kundër Edi Ramës dhe kryeministri i ardhshëm do të ishte Xhafaj. Po mendoj se është një mendësi e përhapur nga Rama që kur të vinte puna, të thoshte që e hoqëm se po komplotonte kundër kryeministrit. Steka tani është te kryeministri. Ka vetëm një mundësi të shpëtojë nga ajo katrahurë që ka bërë. Pasi i kanë ikur dy ministrat të Brendshëm, i është vërtetuar katërcipërisht blerja e votës nga grupet kriminale, atëherë ky grupet duhet sa më parë të largohet. Nëse nuk e bën, është mision i opozitës t'i prijë një aksioni qytetar për ta larguar", deklaroi Nishani. Ai theksoi se modeli i qeverisjes është një model që e ka sjellë vendin në kaos dhe do e çojë në gremë. Nëse kryeministri nuk largohet në këtë situatë që i ka sjellë Shqipërisë, atëherë presioni qytetar duhet ta detyrojë atë të largohet dhe t'u hapë rrugën njerëzve të përgjegjshëm.



Ish-presidenti Bujar Nishani, dje në "Kjo javë" në "News 24"

**PRAPASKENAT**  
"Ka rreth dy muaj që në bazën socialiste po flitet që Xhafaj, Tahiri e të tjerë po komplotojnë kundër Edi Ramës dhe kryeministri i ardhshëm do ishte Xhafaj. Por, mendoj se është një mendësi e përhapur nga Rama që kur të vinte puna, të thoshte që e hoqëm se po komplotonte kundër kryeministrit", tha z.Nishani.

**PD: DAKO DO ARRESTOHEJ TË ENJTEN**  
PD deklaroi dje se kreu i Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako, do të arrestohej të enjten, por dikush e bllokoi policinë. Sekretari i grupit parlamentar të PD-së, Gent Strazimiri deklaroi dje se as kombinacionet brenda qeverisë, as vasaliteti i prokurorisë ndaj Edi Ramës nuk do ta shpëtojnë nga burgu "xhuxhin" e bandave në Bashkinë e Durrësit.

### Propozimi i Kokëdhimës: T'u hapim rrugën 16-vjeçarëve që të votojnë

Kryetari i partisë "Zgjidhja", Koço Kokëdhima, shprehet se adoleshentët e Shqipërisë duhet të kenë të drejtë vote. Ai tha se partia "Zgjidhja" i bën thirrje Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore që ta renditë në agjendë për ta miratuar sa më shpejt ndryshimin e moshës me të drejtë për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur. Kokëdhima nënvizon se adoleshentët e sotëm kanë mendësi europiane, kanë ide unike e të paimponuara, ndaj ata duhet të zgjedhin e të zgjidhen. Sipas Kokëdhimës, ka disa vende anëtare të BE që kanë ulur së fundmi moshën e votimit. Ne e dimë se kjo ide nuk do t'u pëlqejë politikaneve të partive të vjetra. Ata duan në kutitë e votimit dhe në tryezat vendimmarrëse vetëm pensionistë dhe qytetarë dele, skilevër e servilë. Duan militantë trutharë dhe njerëz të shtypur, që nuk kanë aftësi reaguese dhe kurajë qytetare. Partia "Zgjidhja" i bën thirrje Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore që ta renditë në agjendë për ta miratuar sa më shpejt ndryshimin e moshës me të drejtë për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur", tha z.Kokëdhima.



### PDIU: Të çmontojmë sistemin kriminal të Ramës

PDIU shprehet se Edi Ramën s'e shpëton dot më asgjë si përgjegjësi kryesor i kanabizimit të vendit. Mesila Doda deklaroi dje: "Personi përgjegjës që kanabizoi vendin dhe është strateg i kriminit elektoral është vetë kryeministri i vendit, Edi Rama, ndërsa ministrat e tij të Brendshëm, Xhafaj dhe Tahiri, kanë qenë vetëm vegla në arritjen e objektivave të tij me pasja të rënda për vendin". Sipas saj, përballë këtij skandali, PDIU mbështet që veprim të opozitës së bashkuar për të krijuar klimën e favorshme dhe siguritë e domosdoshme për ndryshimin e pushtetit politik të sotëm, që është bazuar dhe ka perfeksionuar blerjen dhe manipulimin e votës, një sistem që ka ngritur Rilindja e Edi Ramës në bashkëpunim me bandat elektorale të vendit. "Është urgjente që të çmontojmë një sistem kriminal që ka shkatërruar çdo besim tek vota e lirë dhe që ka uzurpuar sot çdo segment të institucioneve shqiptare me partine-shtet", - tha zj.Doda.

### DORËHEQJA

Ish-presidenti Nishani komento dorëheqjen e Fatmir Xhafajt nga posti i ministrit të Brendshëm duke u shprehur optimist nga kjo lëvizje. Sipas tij, ky është demontimi i një piramide. "Duket se ka filluar një lloj

demontimi i një strukture. Unë kam besuar gjithmonë që do të vijë një moment që do të fillojë pika e kthesës, sepse nuk besoj se ka alternativë tjetër për një shoqëri, veçse të dalë nga kauza e anarkisë e anomalitetit. Natyrisht që është një rrugë e gjatë, është nevojë për një kthesë të madhe. Por, besoj se zhvillimet e fundit, përfshirë edhe dorëheqjen e min-

istrit të dytë të Brendshëm tregojnë se ka filluar demontimi i kësaj piramide", tha Nishani. I pyetur për arsytet e kësaj dorëheqjeje, Nishani tha se është e kërkuar nga ndërkombëtarët, por përmendi edhe presionin e qytetarëve dhe atë të opozitës. Ish-presidenti u pyet edhe për prapaska të mundshme, teksa tha se ekziston një procedurë që duhet

ndjekur në rastin e dorëheqjes, e cila nuk u zbatua nga Xhafaj. Ish-presidenti tha se ministri i ri i Brendshëm, gjeneral Sander Lleshi, i cili zëvendëson në këtë detyrë Fatmir Xhafajn është një ekstremist politik, që ka fyer Kushtetutën duke qenë gjeneral me uniformë. "Ministrat sot trajnohen si zëdhënës shtypi. Nuk ka rëndësi kush vihet ministër. Personi konkret është një ekstremist politik. Nuk është më gjeneral. Kur ka pasur uniformë, u angazhua në aktivitet politik të njëanshëm. Nuk ka fare rëndësi kush bëhet ministër, pasi ministrat rezultojnë të lidhur me krimin. Të dy ish-ministrat kanë përfituar nga aktivitetet kriminale. Tashmë nuk ka asnjë vlerë, sepse ka humbur çdo sens i besimit dhe i shpresës. Sa më parë qytetarët presin që t'i hapet rrugë shpresës. Lleshi ka fyer Kushtetutën duke qenë me uniformë. Në FA, ushtarakët shërbejnë brenda një termi të caktuar. Nëse nuk merr rezervë e caktuar, ti del nën gradë. Lleshi e mbylli fazën përkatëse dhe doli në rezervë sipas ligjit. Gjykata u mor me dekretin e presidentit", - theksoi z.Nishani.

**Njoftim për shitje me ankand të tretë**  
Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e tretë për pasurinë e dorezanesin K. Sula te ndodhur ne Mallakaster . Pasuria që shitet në ankand përbehet nga :  
\* Pasuria "Ari" me nr. 206/48, me siperfaqe 2500 m2 në ZK 2869 vol. 5 fq 31, dhe "Ari" me nr.206/7 me vol 4, faqe 244, në ZK 2869 vol me siperfaqe 500 m2.  
Ankandi tretë i siperfaqes totale 3.000 m2 fillon me çmim fillestar 806.400 lekë  
\* Pasuria "Nderetese " pjesë e vecuar me nr. 70/15, vol 6, faqe 85 me siperfaqe 51 m2 e ndodhur në ZK 2869 Ankandi tretë fillon me çmimin fillestar 252.419 lekë  
Ankandi është progresiv dhe do të zhvillohet dt 23.11.2018 në orën 15:00 në Bulv "G.Fishta" Kulla 1,Kati 2, zyra5. Kont. tel: 0672082543, e-mailit:ilir\_dervishaj@yahoo.com, WEB www.powerjustice-al.com.

**Njoftim për shitje me ankand**  
Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k bazuar ne nenin 567,568 e vijues te K.Pi.C do të zhvillojë ankandin e pare për pasurinë e pales debitore B Kamberaj dhe L Kamberaj. Pasuria që shitet në ankand përbehet nga :  
\* "Trazul + Godine tre kateshe ", me numer pasurie 14/283 ne Z K Nr.8602, volumi 35, faqe 144, trazul 300 m2, siperfaqe e kati perdithe 117,9 m2 ne Lagjen 10 Korrikune Vlore Ankandi, i pasurisë fillon me çmimin fillestar në masën prej 8.960.000 Lekë  
Ankandi qendron i hapur 15 dite dhe do të zhvillohet në datë 08.11.2018 në orën 15:00 në Bulevardin "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr. 2/Tiranë Ofertuesit duhet të tërheqin dokumentacionin të kontaktojnë me tel. 00355 67 20 82 543 ose e-mailit ilir\_dervishaj@yahoo.com si dhe WEB www.powerjustice-al.com.

REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
Zyra përmbarrimore "Best 2010"  
**SHPALLJE ANKANDI**  
Më datë 26 nëntor 2018 nga ora.08.00-ora.16.00 tek kjo zyrrë përmbarrimore do zhvillohet seanca e fundit e mbledhjes së ofertave për ankandin e III-të, për shitjen e a) nr.pasurie 26/106+1-26, vol 52, fq. 1, ZK.8603, sip. 105 m2 me çmim fillestar 2976750 lekë; b) nr.pasurie 26/187-ND, vol 52, fq.28, sip.513.4 m2 me çmim fillestar 22640940 lekë  
Të dyja prona ndodhen në të njëjtin pallat (i ndodhur përballë Teatrit "Petro Marku", Vlorë) që ka ndërtuar Debitori "CO.BE.IN" shpk (NUIJ 397201218L).  
Për sqarime të mëtejshme kontaktoni në tel: 052226000 ose cel: 0692075 644

Operacioni, policia procedon në gjendje të lirë edhe 3 punonjëse

# Goditet baza e prostitucionit, përfundon në pranga menaxherja e një qendre masazhi

Shpallet në kërkim administratorja, iu ofronin klientëve meshkuj shërbim "ekstra" kundrejt pagesës

TIRANË

Një tjetër qendër masazhi ku ushtronte prostitucion është zbuluar në Tiranë. Burime zyrtare nga policia e kryeqytetit dhe bënë me dije është finalizuar operacioni i koduar "Extra Service 2", gjatë të cilit është arrestuar menaxherja e një qendre masazhi. Bëhet fjalë për 33-vjeçaren Radmilla M., e cila akuzohet për veprat penale "Shfrytëzimi i prostitucionit" dhe "Mbajtja e lokaleve për prostitucion". Ndërkohë, është shpallur në kërkim administratorja 32-vjeçare e qendrës së masazheve "Dimension SPA & Fizioterapi", Ajsela T. Emri i kësaj të fundit del edhe nga kërkimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit, ku rezultoi se është aksionere në qendrën estetike "Dimension Fizioterapi & SPA", që shërben si qendër estetike për masazh, SPA dhe fizioterapi, kurse të formimit profesional për estetike dhe masazher. Mësohet se gjatë stinës së verës, qendra estetike zhvendosej në bregdetin e jugut, kryesisht në Dhërmë. Ndërkaq, janë proceduar në gjendje të lirë edhe tri punonjëse të qendrës në fjalë. "Seksioni për Hetimin e Trafikeve të Paligjshme në D.V.P. Tiranë në kuadër të operacionit policor të koduar "Extra Service 2" bëri arrestimin e shtetasës R.M., 33 vjeçe, banuese në Tiranë, menaxhere e një qendre masazhi në kryeqytet si dhe u shpall në kërkim administratorja e qendrës së masazhit, shtetasja A.T., 32 vjeçe, banuese në Tiranë. Këto shtetase vinin në dispozicion ambientet e qendrës së masazhit për të ushtruar prostitucion nga vajzat e punësuar, të cilat u ofronin klientëve meshkuj shërbime "ekstra" kundrejt pagesës. Në cilësinë e provës materiale u sekuestruan 7 aparate celularë dhe 1 bllok shënimesh. Materialet iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë në ngarkim të shtetasës R.M., dhe A.T. për veprat penale "Shfrytëzimi i prostitucionit" dhe "Mbajtja e lokaleve për prostitucion", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë së Tiranës.



Administratorja e shpallur në kërkim, Ajsela T.



Menaxherja e arrestuar, Radmilla M.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

## EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIIT "PERSON FIZIK"

### GJENDJA E REGJISTRIMIT FILLESTAR

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIIS)	L61306034T
2. Emri i subjektit	Ajsela Teli
3. Forma ligjore	Person Fizik
4. Data e regjistrimit	06/01/2016
5. Fusha e veprimtarisë	Qendër estetike për masazh, SPA dhe fizioterapi. Kurse të formimit profesional për estetike dhe masazher.
6. Vendi i ushtrimit të aktivitetit	Tiranë Tiranë TIRANË Njesia Bashkiake Nr.2, Rruga "Beqir Luga", Pallati Nr.3, Shkalla Nr.1/1, Kati 1
7. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Vlorë Himare DHERMI Lagjja Shkambo, Bulevardi i Plazhit Dhermi. Rruga Kryesore, ambient buze detit me nr pasurie 123/1
8. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: Dimension Fizioterapi & Spa Telefon: 0696346937

### MENAXHERJA

33-vjeçarja Radmilla M., e arrestuar në kuadër të aksionit policor, "Extra Service 2", shfaq shpesh në rrjetet sociale ditët e relaksit, kryesisht në plazhet e jugut, por nuk mungojnë as destinacionet e tjera jashtë vendit. Menaxherja, e cila akuzohet për veprat penale "Shfrytëzimi i prostitucionit" dhe "Mbajtja e lokaleve për prostitucion", një vit më parë ka marrë pjesë në një aktivitet të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, që e ka pasqyruar edhe në rrjetet sociale. Në profilin e saj në "Facebook" nuk mungojë gjithashtu as fotot që shpërndan nga palestra, që duket të jetë një tjetër hobi i saj, apo ato nga SPA-ja, ku zhvillohej aktiviteti i jashtëligjshëm.

### Humb kontrollin e makinës, aksidentohet kryebashkiaku i Këlcyrës



**PËRMET** - Kryebashkiaku i Këlcyrës, Klement Ndoni, është aksidentuar mbrëmjen e së premtes. Burime nga policia dhe bënë me dije se ngjarja ka ndodhur rreth orës 19:00, shumë pranë grykës së Këlcyrës. Mësohet se kreu i bashkisë, Ndoni ka humbur kontrollin e automjetit të tij, ku ndodheshin edhe dy persona të tjerë dhe konkretisht, Sandër Seferi dhe Hodian Selmani, ky i fundit kryetar i Partisë Socialiste në Këlcyrë. Për pasojë, makina është përplasur me bordurën anësore dhe më pas ka dalë nga rruga. Sipas burimeve të mësipërme, kryebashkiaku Klement Ndoni ka marrë plagë në njërin krah, ndërsa dy personat që udhëtonin me të kanë pësuar dëmtime të lehta dhe janë jashtë rrezikut për jetën. Ata janë dërguar gjatë natës për ndihmë mjekësore në spitalin rajonal "Omer Nishani" të Gjirokastrës.

### Dy shqiptarët përleshën me thika në Athinë, plagoset njëri



**GREQI** - Përleshje e egër me një të plagosur në Marroussi në Athinë. Ngjarja ka ndodhur pasditen e së premtes në Rrugën "Nicolao Plastiras" në Marrousi të Athinës. Sipas medieve greke, protagonistët ishin dy shqiptarë. Një burrë sulmoi një tjetër me një thikë, duke shkakuar plagë të shumta në krahunor, krahë dhe këmbët. Menjëherë ka shkuar në vendngjarje policia dhe ambulanca dhe i plagosuri u transportua për në spital, ndërkohë që agresori u arrestua nga policia. Ende nuk është bërë publike se cili ishte shkak i këtij sulmi të egër me thika me dy shqiptarëve, shkruan "zougla.gr" referuar "marousi24.gr".

## Digjen sipërfaqe pyjore në Kaninë, zjarri dyshohet i qëllimshëm



**VLORË** - Disa vatra zjarri janë shfaqur pasditen e djeshme në afërsi të kalasë së Kaninës në Vlorë, deri në dalje të fshatit, në vendin e quajtur "Bishti kalldrëmit". Menjëherë forcat e zjarrfikëse shkuan në vendin

ku ka rënë zjarri dhe nisën punën për izolimin dhe shuarjen e flakëve. Ndërkaq, mësohet se zjarrfikësit kanë hasur në vështirësi për shkak të erës që ndihmon përhapjen e zjarrit. Burime për "GSH" pohuan se zjarri

ka rënë fillimisht në afërsi të disa banesave, duke rrezikuar ullinj të disave vjeçarë. Paraprakisht mësohet se zjarri dyshohet se ka qenë i qëllimshëm. Ndërkaq, uniformat blu vijojnë nësisht hetimet.



Ishte në kërkim ndërkombëtar nga policia shqiptare. I dënuar në Itali me 6.6 vite burg

TIRANË

**E**nver Bajri, i cilësuar si "truri" i grupit kriminal Bajri të Shkodrës është arrestuar mesditën e djeshme në Spanjë. 45-vjeçari i shpallur në kërkim nga autoritetet shqiptare është prangosur një muaj pas operacionit të koduar "Oazi", i cili u zhvillua në Tiranë, Shkodër dhe Rotterdam të Holandës e u finalizua me arrestimin e 11 personave. Burime zyrtare nga Policia e Shtetit dje bënë me dije se në koordinim të plotë dhe intensiv të veprimeve me policinë spanjolle dhe policinë italiane kanë arritur të ndalojnë shtetasin në kërkim ndërkombëtar, Enver Bajri. Ai dyshohet se drejton grupin që ishte aktiv në Shkodër dhe që akuzohet për një sërë veprash të rënda penale, nga trafiku i drogës, vrasje, vrasje e mbetur në tentativë, krijim të grupi të strukturuar kriminal, organizim i lotarive të palejuara dhe armëmbajtje pa leje. Mësohet se 45-vjeçari Bajri u ndalua rreth orës 11:30 minuta të ditës së djeshme në San Huan, Alicante të Spanjës. Policia e Shtetit ishte në gjurmim të tij, duke përdorur metoda speciale të hetimit dhe në bashkëpunim me agjencitë e huaja ligjzbatuese, arritën të konkretizojnë kërkimin me arrestimin e tij. Bajrit në momentin e ndalimit iu gjet një armë pistoletë, që e mbante pa leje si dhe rreth 9 mijë euro. Ai është i dënuar edhe në Itali me 6.6 vite burg për veprat penale "Organizim i emigracionit të paligjshëm", "Shfrytëzimin prostitucioni" dhe "Falsifikim".

#### OPERACIONI "OAZI"

Më 22 shtator të këtij viti, Policia e Shtetit në bashkëpunim me Prokurorinë e Krimeve të Rënda në Tiranë kanë goditur dhe shkatërruar një nga grupet më të rrezikshme kriminale në veri të

# Arrestohet në Spanjë Enver Bajri, i dyshuar si "koka" e grupit kriminal "Bajri"

*Në momentin e ndalimit, 45-vjeçarit iu gjet një pistoletë dhe një shumë prej 9 mijë eurosh*



I arrestuari, Enver Bajri



Pistoleta e sekuestruar nga policia spanjolle

vendit tonë. Bëhet fjalë për bandën "Bajri", e cila prej shumë vitesh ishte kthyer në terrin e banorëve të qytetit verior. 11 persona janë arrestuar gjatë operacionit të koduar "Oazi" që u shtri në Tiranë, Shkodër dhe Rotterdam të Holandës. Ndërkohë, blutë nuk arritën të vinin në pranë Enver Bajrin, i cili konsiderohet si drejtuesi i këtij grupi kriminal. 45-vjeçari është shpallur në kërkim bashkë me një tjetër person me inicialet N.H. Sipas hetimeve të Prokurorisë së Krimeve të Rënda, Enver Bajri është personi që drejtonë të gjithë punën grupit nga trafiku i drogës deri tek gjobëvëniet. Mësohet se Enver Bajri është djali i xhaxhait të Safet Bajrit. Ky i fundit u arrestua të premtën në Tiranë, ndërsa cilësohet si i

#### ARRESTIMI NË ALICANTE

45-vjeçari Bajri u ndalua ditën e djeshme në San Huan, Alicante të Spanjës. Policia e Shtetit ishte në gjurmim të tij, duke përdorur metoda speciale të hetimit dhe në bashkëpunim me agjencitë e huaja ligjzbatuese arritën ta arrestonin. Bajrit në momentin e ndalimit iu gjet një armë pistoletë, që e mbante pa leje si dhe rreth 9 mijë euro. Ai është i dënuar edhe në Itali me 6.6 vite burg për veprat penale "Organizim i emigracionit të paligjshëm", "Shfrytëzimin prostitucioni" dhe "Falsifikim".

"forti i Shkodrës". Pas operacionit të suksesshëm, kreu i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu dhe kryeprokurorja e Krimeve të Rënda, në një konferencë për shtyp bënë publik emrat e personave të arrestuar, disa prej të cilëve u kapën në Holandë dhe të tjerët në Shqipëri. Arrestimet në fjalë u bënë në

kuadër të operacionit "Forca e Ligjit". Po të njëjtat burime sqaruan se në zbatim të urdhrët të Prokurorisë së Krimeve të Rënda u sekuestruan një resort-hotel në Velipojë dhe një lokal në Shkodër; pasi dyshohet se janë produkt i ardhur nga aktiviteti kriminal. Po ashtu, u sekuestruan edhe 3 autom-

jete dhe një numër i konsiderueshëm celularësh.

#### HETIMET

Mësohet se veprimet hetimore, nën drejtimin e Prokurorisë së Krimeve të Rënda, deri në goditjen e plotë të gjithë grupit kriminal "Bajri" kanë zgjatuar mbi 6 muaj. Burime zyrtare thanë se hetimet u bazuan tek dhjetëra orë përgjime, mijëra informacione të shkëmbyera me partnerët, u analizuan mijëra faqe të dhëna, si edhe u kryen veprime pro-aktive në terren, përmes kontrollit nga ajri (dron) dhe vëzhgimit intensiv. Oficerë të Policisë së Shtetit, në bashkëpunim me oficerë të taktikës të vendeve të përfshira në operacion kanë kryer veprime në terren për evidencimin, lokalizimin dhe ndalimin e shtetasve anëtarë të

grupit, që vepronin jashtë Shqipërisë, kryesisht në Holandë. Akuzat ndaj anëtarëve të këtij grupi kriminal janë "Vrasje me dashje e mbetur në tentativë", në bashkëpunim, "Vrasje me dashje", e kryer në bashkëpunim, "Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve dhe municioneve luftarake", "Organizim i lotarive të palejuara", "Pastrim i produkteve të veprës penale" të kryer në bashkëpunim, "Shtrengim me anë të kanosjes ose dhunës për dhënie të pasurisë", kryer në bashkëpunim, "Përkrahje e autorit të krimi", "Moskallëzim krimi", "Prodhim e shitje e lëndëve narkotike", vepra penale këto të kryer në kuadër të grupit të strukturuar kriminal. Si vepra të rënda kriminale, të dokumentuara deri tani janë 2 vrasje të ndodhura në Shkodër, ngjarje e ndodhur në 7 shkurt 2001, ku u vra shtetasi A.T. dhe ngjarje e datës 20 qershor 2002, ku u vra shtetasja F.H., 15 vjeçe. Gjatë veprimeve hetimore ka rezultuar edhe është provuar në javët e fundit se anëtarë të këtij grupi kriminal kanë kanosur dhe shtrenguar disa shtetas për dhënie shumash të konsiderueshme parash. Ky grup është i dyshuar dhe po hetohet intensivisht për disa nga ngjarjet e fundit të ndodhura në Shkodër.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BANKA E SHQIPERISE  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

### TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje dhe implementim i disa pajisjeve të rrjetit për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 12,700,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10:00 – 13:00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraqitshëm pagesën e paktyshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfytuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 2221; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje dhe implementim i disa pajisjeve të rrjetit për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 23 Nentor 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

## Merrte ryshfet kundrejt premtimit për një vend pune, prangoset zyrtarja në Berat

**BERAT** – Policia e Beratit ka arrestuar drejtoreshën e Qendrës Sociale për Punë dhe Mirëqenie, Tatjana Toska. 50-vjeçarja ishte shpallur në kërkim me akuzën për korupsion pasiv dhe mashtrim pas publikimit të rastit në një emision investigativ. Gjykata e Shkallës së Parë Berat ka caktuar masën "Arrest me burg" për Toskën, e cila akuzohet se merrte ryshfet për punësim në qendrën sociale. "Nga specialistët e seksionit për Hetimin e Krimit



Ekonomik dhe Financiar u bë ndalimi i shtetasve së shpallur në kërkim, Tatjana Toska, 50 vjeçe, banuese në lagjen '30 Vjetori', Berat. Ndalimi i saj u bë, pasi Gjykata e Shkallës së Parë Berat, me

vendimin nr. 24 datë 26.10.2018, ka caktuar masën e sigurisë 'Arrest me burg', e dyshuar për veprat penale 'Korupsion pasiv në sektorin privat' dhe 'Mashtrim'.





Përfaqësuesi me prokurë										Përfaqësuesi me prokurë									
Nr	Nr kërkesë	Date Kërkesë	Emer	Atesl	Mbiemer	Date Kërkesë	Nr 1 zones Kadastrale	Nr 1 pasurisë		Nr	Nr kërkesë	Date Kërkesë	Emer	Atesl	Mbiemer	Date Kërkesë	Nr 1 zones Kadastrale	Nr 1 pasurisë	
100	1787-A	01.03.2018	BKT SH.A			TIRANE	8170	2/217		195	1435-G	05.07.2018	ILIRIANA	MUSA	BASHA	ELBASAN	8527	1414/14	
101	1801-B	12.03.2018	ASLLAN DERGUT		SHARRA	TIRANE	8120	6/435		196	2062-A	05.07.2018	DRITA	HYSNI	CANKJA	ELBASAN	8526	9/71	
102	1801-A	12.03.2018	ARTUR AZMI		KERLUKU	TIRANE	8120	6/435		197	2044-C	09.07.2018	ANILA	MUSTAFA	KATRO	ELBASAN	8527	1374/2/1	
103	1802-A	12.03.2018	AGRON TEKI		TELA	ELBASAN	8525	29/230		203	1965-C	10.07.2018	LIRI	MEHMET	LEKA	TIRANE	8340	4/972	
104	915-D	15.03.2018	AURORA BEDRI		BEHLULA	TIRANE	8310	6/425		198	2078-B	10.07.2018	LINDITA	QANI	KILI	VLORE	8605	33/385	
105	915-C	15.03.2018	NEXHMIJE MEHMET		HOXHA	TIRANE	8310	6/425		199	2078-A	10.07.2018	THEMIDA	QANI	KONDI	VLORE	8605	33/385	
106	1818-A	15.03.2018	ROZA JOVAN		LLAKMANI	KORÇE	3664	17/4		200	2079-C	10.07.2018	LINDITA	QANI	KILI	VLORE	8605	34/151	
107	915-E	21.03.2018	GENCI QAMIL		PALANIKU	TIRANE	8310	6/425		201	2079-B	10.07.2018	NATASHA	QANI	TOTO	VLORE	8605	34/151	
108	1802-B	21.03.2018	FELATUN MAZLLEM		KARAISKAJ	ELBASAN	8525	29/230		202	2079-A	10.07.2018	THEMIDA	QANI	KONDI	VLORE	8605	34/151	
109	1583-H	26.03.2018	LEDRI GANI		KARROÇI	TIRANE	8180	6/238		206	2081-C	10.07.2018	LINDITA	QANI	KILI	VLORE	8605	24/87	
110	1152-G	05.04.2018	DILE ZENEL		MURTHI	TIRANE	8340	4/122		207	2081-B	10.07.2018	NATASHA	QANI	TOTO	VLORE	8605	24/87	
111	1818-B	23.04.2018	ANTONELAILIR		VESHI	KORÇE	3664	17/4		208	2081-A	10.07.2018	THEMIDA	QANI	KONDI	VLORE	8605	24/87	
112	1252-E	24.04.2018	MIMOZA PETRIT		SELENICA	ELBASAN	8527	165/18		204	2083-A	10.07.2018	AGRON	TEKI	TELA	ELBASAN	8527	160/5	
113	1802-C	24.04.2018	MIMOZA PETRIT		SELENICA	ELBASAN	8525	29/230		205	2084-A	10.07.2018	AGRON	TEKI	TELA	ELBASAN	8527	168/1	
114	270-P	03.05.2018	PRANVERA SHABAN		BEJA	TIRANE	8160	4/410		213	1242-C	11.07.2018	ENDRIT	PETRIT	STANI	TIRANE	8270	6/363	
115	894-P	09.05.2018	ARBEN HASAN		ALUSHI	ELBASAN	8527	133/1		212	1243-F	11.07.2018	MAJLINDA	NESHDET	VEIZI	VLORE	8604	3/100	
116	1714-D	10.05.2018	SHEJNAZE KADRI		PAZARI	ELBASAN	8527	1372/7		214	2095-A	11.07.2018	LUANESHA	GANI	BERISHA	ELBASAN	8526	383/30	
117	1801-C	10.05.2018	HAXHI MEHMED		VATHI	TIRANE	8120	6/435		210	2096-B	11.07.2018	QAZIM	XHEMAL	XHEPA	ELBASAN	8527	1426/5	
118	1914-A	14.05.2018	KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPERISE			TIRANE	8170	1/138		211	2096-A	11.07.2018	NURI	RIZA	XHEPA	ELBASAN	8527	1426/5	
120	1915-A	14.05.2018	KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPERISE			TIRANE	8170	1/635		209	2097-A	11.07.2018	MITHAT	XHEVDE	SKILJA	ELBASAN	8527	1426/27	
121	1916-A	14.05.2018	KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPERISE			TIRANE	8170	1/175		216	2098-A	11.07.2018	ABDYL	QAMIL	KACOLLJA	ELBASAN	8526	82/1	
122	1917-A	14.05.2018	KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPERISE			TIRANE	8170	1/363		217	2098-B	11.07.2018	SHEJNAZ	QAMIL	CEKA	ELBASAN	8526	82/1	
119	1919-A	14.05.2018	KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPERISE			TIRANE	8170	1/138		218	2098-C	11.07.2018	SUZANA	QAMIL	KOTORRI	ELBASAN	8526	82/1	
123	1921-A	14.05.2018	SOKOL PETRIT		KOSOVA	DURRES	8515	5/1684		215	2100-A	11.07.2018	AGRON	TEKI	TELA	ELBASAN	8527	168/1	
124	1712-C	21.05.2018	ARTUR BEKHET		QYTETI	KORÇE	8562	5/694		219	733-Q	12.07.2018	LUAN	OSMAN	REÇI	TIRANE	8320	2/453	
125	1712-D	21.05.2018	KADRI FIQIRI		SHURDHO	KORÇE	8562	5/694		223	2083-C	12.07.2018	ANITA	MASAR	ALIÇKA	ELBASAN	8527	160/5	
126	1712-B	21.05.2018	FLUTUR RUZHDI		AGOLLI	KORÇE	8562	5/694		224	2083-B	12.07.2018	FELATUN	MAZLLEM	KARAISKAJ	ELBASAN	8527	160/5	
127	1801-D	21.05.2018	ASLLAN DERGUT		SHARRA	TIRANE	8120	6/435		225	2083-D	12.07.2018	SHEGUSHE	MAS HAR	KOSOVA	ELBASAN	8527	160/5	
128	1801-E	24.05.2018	EDI AGRON		SHARRA	TIRANE	8120	6/435		226	2084-C	12.07.2018	ANITA	MASAR	ALIÇKA	ELBASAN	8527	168/1	
129	1802-D	25.05.2018	SHEGUSHE MAS HAR		KOSOVA	ELBASAN	8525	29/230		227	2084-B	12.07.2018	FELATUN	MAZLLEM	KARAISKAJ	ELBASAN	8527	168/1	
130	807-B	28.05.2018	BEQIR IBRAHIM		HUSHA	TIRANE	8120	8/560		228	2084-D	12.07.2018	SHEGUSHE	MAS HAR	KOSOVA	ELBASAN	8527	168/1	
131	1712-E	28.05.2018	PETRIT FUAT		HAJDERLLI	KORÇE	8562	5/694		220	2100-C	12.07.2018	ANITA	MASAR	ALIÇKA	ELBASAN	8527	168/1	
132	1936-A	29.05.2018	KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPERISE			TIRANE	8360	1/193		221	2100-B	12.07.2018	FELATUN	MAZLLEM	KARAISKAJ	ELBASAN	8527	168/1	
133	1818-C	07.06.2018	LILIANA THANAS		KOSTANDINIKORÇE		3664	17/4		222	2100-D	12.07.2018	SHEGUSHE	MAS HAR	KOSOVA	ELBASAN	8527	168/1	
134	1396-B	08.06.2018	INDRIT IHSAN		BANKA	TIRANE	8120	8/426		229	2115-A	13.07.2018	BAKUSHE	KADRI	KOLA	TIRANE	8190	13/416	
135	1397-B	08.06.2018	INDRIT IHSAN		BANKA	TIRANE	8120	8/427		232	1264-G	17.07.2018	DORINA	AQIF	XHANI	ELBASAN	8526	1299/4	
136	733-P	11.06.2018	MURAT HASIM		KALAJA	TIRANE	8320	2/453		230	1361-G	17.07.2018	ILIRIANA	MUSA	BASHA	ELBASAN	8527	1376/19	
137	1161-I	11.06.2018	ENDRI SHERIF		CULLHAJ	TIRANE	8230	5/386		231	1367-H	17.07.2018	ILIRIANA	MUSA	BASHA	ELBASAN	8527	1376/6	
138	1161-H	11.06.2018	SADETE BEDRI		ÇAUSHI	TIRANE	8230	5/386		233	2098-D	17.07.2018	ELISABETA	QAMIL	GRYKSHI	ELBASAN	8526	82/1	
139	1323-M	11.06.2018	MURAT HASIM		KALAJA	TIRANE	8320	2/453		234	2098-E	17.07.2018	SKENDER	QAMIL	KACOLLJA	ELBASAN	8526	82/1	
140	1360-I	12.06.2018	GENC ESAT		JASA	TIRANE	8270	6/453		235	1307-O	18.07.2018	REPIK	HAXHI	ABAZI	TIRANE	8190	15/387	
141	1345-E	13.06.2018	EDLIRA REMZI		MARA	TIRANE	8210	7/279		236	2063-H	20.07.2018	SHPRESA	XHEVDE	BUMI	ELBASAN	8526	2276/1	
142	1323-N	18.06.2018	LUAN OSMAN		REÇI	TIRANE	8320	2/453		237	2036-I	24.07.2018	ROLAND	RUZHDI	EKMEÇIU	ELBASAN	8526	2276/1	
146	1958-A	18.06.2018	AGRON TEKI		TELA	ELBASAN	8527	161/4		238	1306-J	25.07.2018	ARBA	GAZMEND	JASA	TIRANE	8270	6/453	
143	1959-A	18.06.2018	AGRON TEKI		TELA	ELBASAN	8527	162/2		239	2036-J	26.07.2018	ZHANETA	MUSTAFA	MADHI	ELBASAN	8526	2276/1	
144	1960-A	18.06.2018	AGRON TEKI		TELA	ELBASAN	8527	171/15		240	2145-A	26.07.2018	AGRON	TEKI	TELA	ELBASAN	8525	29/228	
145	1961-A	18.06.2018	AGRON TEKI		TELA	ELBASAN	8527	159/13		242	2147-A	27.07.2018	HAMID	KADRI	BALLA	TIRANE	8190	13/431	
148	1161-K	19.06.2018	REXHEP BEDRI		CULLHAJ	TIRANE	8230	5/386		241	2148-A	27.07.2018	SHKELZEN	NYSRET	KASTRATI	SHKODER	8591	15/952	
149	1161-J	19.06.2018	EMINE BEDRI		SHIMA	TIRANE	8230	5/386		243	2162-A	30.07.2018	ERJON	YMER	SYZIU	TIRANE	8260	4/627	
147	1440-B	19.06.2018	SHPRESA AHMET		CIÇI	TIRANE	8120	4/322		244	896-J	31.07.2018	RIZA	NEXHMI	TARTARI	TIRANE	8220	8/317	
150	1965-A	19.06.2018	FATMIR BESIM		MURTHI	TIRANE	8340	4/972		245	1636-C	01.08.2018	NINFA	SKENDER	ZIU	VLORE	8605	13/192	
152	1440-C	20.06.2018	MELEGE ZENEL		AVDIU	TIRANE	8120	4/322		246	878-C	02.08.2018	ILIR	JONUZ	LLACI	TIRANE	8170	7/309	
153	1965-B	20.06.2018	JEMINE MEHMET		KORÇA	TIRANE	8340	4/972		249	1117-C	03.08.2018	ARBEN	TOMORR	ALIAJ	ELBASAN	8526	1222/15	
151	1969-A	20.06.2018	ENGLESINA SHAQO		PARLLAKU	TIRANE	8190	5/501		250	1161-M	03.08.2018	KUJTIM	BAJRAM	CULLHAJ	TIRANE	8230	5/386	
154	1440-D	23.06.2018	ENVER ZENEL		DUKA	TIRANE	8120	4/322		248	2172-A	03.08.2018	ALBANA	AZIS	HOXHA	TIRANE	8330	1/348	
155	1668-D	23.06.2018	FATLINDA ALI		STRUGA	TIRANE	8190	2/199		247	2174-A	03.08.2018	ALBANA	AZIS	HOXHA	TIRANE	8330	1/360	
156	2007-A	23.06.2018	HATIXHE RASIM		ÇEREKJA	ELBASAN	8526	9/161		251	1161-N	04.08.2018	FATIME	BEDRI	MANSAKU	TIRANE	8230	5/386	
159	1161-L	25.06.2018	GEZIM SEIT		CULLHAJ	TIRANE	8230	5/386		252	2078-C	06.08.2018	ENGJELL	QANI	DINE	VLORE	8605	33/385	
169	1958-D	25.06.2018	FELATUN MAZLLEM		KARAISKAJ	ELBASAN	8527	161/4		253	2079-D	06.08.2018	ENGJELL	QANI	DINE	VLORE	8605	34/151	
170	1958-C	25.06.2018	SHEGUSHE MAS HAR		KOSOVA	ELBASAN	8527	161/4		254	2081-D	06.08.2018	ENGJELL	QANI	DINE	VLORE	8605	24/87	
171	1958-B	25.06.2018	MIMOZA PETRIT		SELENICA	ELBASAN	8527	161/4		255	1117-E	07.08.2018	ARIF	BEXHET	HYSKJA	ELBASAN	8526	1222/15	
160	1959-D	25.06.2018	FELATUN MAZLLEM		KARAISKAJ	ELBASAN	8527	162/2		256	1117-F	07.08.2018	LORETA	SHYQYRI	QOSJA	ELBASAN	8526	1222/15	
161	1959-C	25.06.2018	SHEGUSHE MAS HAR		KOSOVA	ELBASAN	8527	162/2		257	989-N	10.08.2018	AFERDITA	XHAFER	DALLIU	TIRANE	8310	5/115	
162	1959-B	25.06.2018	MIMOZA PETRIT		SELENICA	ELBASAN	8527	162/2		258	1134-P	10.08.2018	AFERDITA	XHAFER	DALLIU	TIRANE	8310	7/48	
163	1960-C	25.06.2018	FELATUN MAZLLEM		KARAISKAJ	ELBASAN	8527	171/15		259	2003-B	10.08.2018	MEHMET	ZYBER	BELBU	TIRANE	8190	8/990	
164	1960-D	25.06.2018	MIMOZA PETRIT		SELENICA	ELBASAN	8527	171/15		260	2176-A	10.08.2018	SILVANA	MEHMET	PREBILA	ELBASAN	8527	307/1	
165	1960-B	25.06.2018	SHEGUSHE MAS HAR		KOSOVA	ELBASAN	8527	171/15		261	982-O	14.08.2018	SHAQIR	RIZA	LUNIKU	ELBASAN	8527	175/7	
166	1961-D	25.06.2018	FELATUN MAZLLEM		KARAISKAJ	ELBASAN	8527	159/13		262	1790-D	16.08.2018	ERIOLA	FATMIR	NALLBANI	TIRANE	8170	3/304	
167	1961-B	25.06.2018	MIMOZA PETRIT		SELENICA	ELBASAN	8527	159/13		263	1790-E	20.08.2018	ARJAN	HASAN	NALLBANI	TIRANE	8170	3/304	
168	1961-C	25.06.201																	

# BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ  
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET  
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR  
QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com  
**BW**

FALAS





## TRAFIKU I DROGES

### REPORTAZH

Historia e Hasit, që mbante brenda një rafineri heroine është e lidhur me atë të 54-vjeçarit Liman Beu

# "Corriere Della Sera": Si funksiononte rrjeti i drogës nga Hasi në Milano, Itali

*"Sundimi" i bandave të Kalabrisë, shpesh aleate, nuk "respektohet" gjithmonë nga klanet shqiptare*

Fshati i barinjve dhe fermerëve në malet e verilindjes së Shqipërisë, në Has, 1300 kilometra larg nga Milano, ndihmon për të kuptuar gjeografinë e drogës, e cila shpesh mbërrin në Itali, "porta" e hyrjes për në pjesën tjetër të Evropës, shkruan gazeta italiane "Corriere", që duke iu referuar hetimeve të Prokurorisë së Përgjithshme në Tiranë, thotë se droga mbërrin në qytetin e Milanos për t'u shpërndarë aty më pas.

Në shkrim thuhet se operacioni për goditjen e 4 grupeve kriminale të përfshirë në trafikun e drogës u drejtua personalisht nga kreu i policisë shqiptare, Ardë Veliu dhe është ende në zhvillim.

Sipas shkrimit, zgjedhja e fshatit të largët në Has të kujton mënyrën e veprimeve të klaneve shqiptare, që operojnë në komunitete të varfra dhe të izoluar duke blerë heshtjen e tyre.

Historia e Hasit, ku ishte ngritur një laborator për përpunimin e heroinës, lidhet me atë të 54-vjeçarit Liman Beu, i njohur ndryshe si "Mani". Gazeta ndalon gjatë në përshkrimin e fierakut që u arrestua në Kavajë ndërsa kërkohet në Itali, ku jetoi që i ri mes Milanos dhe Breshias dhe u përfshi në grabitje të armatosura, shfrytëzim prostitucioni si dhe trafikun e lëndëve narkotike.

#### SHKRIMI I PLOTË

Një fshat barinjsh e fshatës në malet e Verilindjes shqiptare, rreth 1300 kilometra larg nga Milano, Hasi ndihmon për të kuptuar gjeografinë e drogës, që arrin shpesh në Itali, "porta" e hyrjes për pjesën tjetër të Europës dhe mbi të gjitha, siç tregojnë hetimet e Prokurorisë së Përgjithshme të Tiranës, që arrin në



Droga e sekuestruar në Has

këtë qytet për t'u ndalur dhe më pas shpërndarë.

Historia e Hasit, që mbante brenda tij një rafineri heroine është e lidhur me atë të 54-vjeçarit Liman Beu, i ashtuquajtur "Mani" (shkurtime i emri të tij), një prej të arrestuarve mes 44 të policisë shqiptare.

Hetuesit italianë, ekspertë të mafieve ballkanike e njohin mirë "Manin" për shkak të së kaluarës së tij, dënimin, arratinë dhe kërkimin nga Interpol, dhe sepse në itinerarin e tij kriminal, ai sintetizon "profesionalizmin" që ka marrë kriminaliteti në Lindje. Jo më ose jo vetëm plaçkitës të egër, por menaxherë të së keqes; jo më ose jo vetëm shpërndarës të vegjël, por narkotrafikantë.

Në rrugën e opiumit Për shkak të peshës së tij, ky operacion ka arritur një pikë kyçe në itinerarin e tij në orët e fundit, por ende në zhvillim është drejtuar personalisht nga kreu i policisë shqiptare, Ardë Veliaj. Në rafinerinë e krijuar në Has u gjetën 150 kilogramë opium, të nxjerra nga bima e lulëkuqes që pasi përpunohet, prodhon heroinën.

#### OPIUMI VINTE NGA TURQIA.

Zgjedhja e fshatit të Hasit ndjek një "mënyrë veprimi" të klaneve shqiptare, të

cilat blejnë heshtjen e komuniteteve të izoluar dhe shumë të varfra, duke i vënë roje përgjatë rrugëve të afërta dhe zgjedhin shtëpi të braktisura për t'i transformuar në laboratorë me praninë e shpesh të kimistëve kolumbianë, të paguar shtrënjtë si në merkaton e futbollit, që mësojnë procesin e punës.

Nga kjo rrjedh se metoda e hetimit i ngjan asaj që është e nevojshme për të luftuar Ndranghetan, në shtëpinë e saj në Aspromonte: një aktivitet obsesiv dhe i duruar i dëgjimit të territorit.

#### KATËR GRUPET

Operacioni i policisë ka shkatërruar katër banda. Një prej tyre i kishte garantuar mbrojtje "Manit", që ishte fshehur në Jug të vendit, në Fier dhe që është kapur dhe arrestuar nga komisarati që drejtohej nga Artur Selimaj. Ai kishte mbërritur kur ishte i ri në Itali, duke jetuar mes Milanos dhe Breshias (gjyqata e së cilës kishte marrë vendimin e fundit dhe atë përfundimtar duke e detyruar të arratisë), Liman Beu i përket një familjeje që lëviz koka nën mes Milanos dhe Holandës. "Mani" e kishte nisur "karrierën" me grabitjet e armatosura. Më pas kishte hyrë në shfrytëzimin

e prostitucioni, fillimisht si kontrollues në rrugë dhe në vijim si "padron" i vazjavë; në fund i kishte investuar para e fituara në grupet e para të drogës. Fakti që kishte mbi veten një mandat arresti nuk i kishte krijuar stres. Është "zakon" i shqiptarëve të kërkuar të marrin në kohë reale lajmet, si psh. dënimet dhe urdhra arresti, të cilat duhet të lëvizin të mbrojtura dhe ekskluzivisht në kanale institucionale, në mënyrë që të organizonin në vend të fshehtë solid. Paratë këtyre banditëve nuk iu mungojnë kurë dhe me para mund të blihet gjithçka, përfshirë lirinë.

#### RRUGËT DHE NGARKESAT

Elementë të tjerë të bandave janë ndalur në Shkodër e Vlorë nga komisaritetet e drejtuara nga Vasil Çelaj dhe Alket Ahmetaj. Ashtu si Selimaj, ata janë drejtues që duhet të përmenden: ata përfaqësojnë drejtimin e ri të policisë shqiptare, dyzet dhe pesëdhjetëvjeçarë të formuar falë bashkëpunimit italian që ka lejuar rritjen e nivelit hetimor: edhe pse përvoja e protagonistëve të drejtpërdrejtë agjentë të rinj në vitet e luftës civile vlen sa një CV të tërë.

Nga Fieri "Mani" ishte

#### OPERACIONI "VOL-VO 4"

##### EMRAT QE U LANË NE BURG

1. Hajri Seferi
2. Jasin Kala (alias Jasin Avdyli)
3. Shkelqim Avdyli
4. Astrit Avdyli (alias Sulejmani)
5. Saimir Gjepali
6. Altin Avdyli
7. Jasin Avdyli
8. Fatos Llaftiu
9. Denis Llaftiu
10. Esat Mehmeti
11. Saimir Sulejmani
12. Elis Guri
13. Ilirjan Prifti
14. Petro Kuci (alias Abedin Kuci)
15. Ardit Gjyriqi
16. Elton Shehaj
17. Armand Spiro
18. Arben Cuko
19. Zef Lazri
20. Artur Balla
21. Arben Ndoka
22. Gjevi Ndoka (alias Xhevair)
23. Bledi Ndokaj
24. Paulin Simoni
25. Zef Lazri

##### NE "ARREST SHTEPIE"

1. Bledar Koci (arrest shtëpie)
2. Lule Zeneli (arrest shtëpie)
3. Luigj Paloka (arrest shtëpie)
4. Kol Lleshi (arrest shtëpie)
5. Vlash Gazulli (arrest shtëpie)
6. Zef Ndoka (arrest shtëpie)
7. Vasil Nika (arrest shtëpie)
8. Genc Zeneli (arrest shtëpie)

##### DETYRIM PARAQITJE

1. Mimoza Ndoka (detyrim paraqitje)
2. Marjeta Perskura (detyrim paraqitje)

në gjendje të menaxhonte biznesin e drogës dhe të ruante rrugët, ngarkesat dhe fitimet. Fundi i tij mund të prodhojë një luftë për të zënë vendin bosh. Edhe sot "sundimi" i bandave të Kalabrisë, shpesh aleate – të mos qëllonjë por të ruajnë gjurmët – nuk "respektohet" gjithmonë nga klanet shqiptare.

#### REZULTATET E OPERACIONIT

• Rreth 160 persona të identifikuar me precedentë apo prishës të rendit, të konsideruar si "të fortë" janë ndalur apo arrestuar, ndër ta rreth 70 veta për armëmbajtje pa leje.

• Janë kapur e arrestuar 154 persona, për të cilët ka pasur një urdhër kërkimi kombëtar dhe 14 të tjerë në kërkim ndërkombëtar për vepra të ndryshme penale.

## FILMI



# Rrëfimi i “Azizit”, një film për të shkuarën e të tashmen

Fatmira Nikolli

*Historia e familjes nga Dibra dhe të mbijetuarit të tri kampeve*

Dëgjohej të bërtitura në oborr. Ai vrapon t'i arrijë zërat. Kur mbërrin dora e një polici, e tërheq dhe e përplas dhe e pyet për të atin. Ka ulërima e frikë, polici kap të ëmën, pastaj motrat, i rrasin në një “Zis” ngjyrë ushtarake bashkë me të tjerë. Rruga do të jetë e gjatë. Të moshuarit e drobitur janë pa fjalë, ndërsa nënat i tërheqin fëmijët pas vetes, u mbulojnë kokën që të mos shohin se si than bari teksa jeta e tyre merr flakë. Të qarat e foshnjave nuk pushojnë, as aty, as rrugës, as aty ku do të mbërrijnë, as ditëve, as netëve, kur shpirttrat fikën në mesnatë e të vegjlit nuk ia dalin të jetojnë më, kur vaji i tyre i ngjan vajit të Ajkunës, e vajat nuk pushojnë me fjalë e me zë, kur as qivurë nuk gjenden për të vdekurit që i shkuan ditët e fundit të jetës me copa kotheresh plot myk, që ua hodhën me thasë si të ishin bagëti.

\*\*\*  
Azizi ngrihet në këmbë për të përshëndetur një sallë që e duartroket. Portreti plot rrudha e fsheh jetën e tij, trupi i imët, i lodhur flet vetëm për vitet, pa e treguar si qenë ato. Përkrah ka të birin. Duket i qetë se ka mundur të jetë përkrah tij çdo ditë, ndryshe nga ai që u nda me të atin, kur ishte ende i vogël për të kuptuar se ajo që do vinte pas ditës kur do e përshëndeste atë për herë të fundit, do të ishte e frikshme. Publiku është përlotur. Shumica prej tij në moshë të re, ka parë për 60 minuta një udhëtim nëpër vendet e torturës komuniste. E megjithatë, kur pat lindur në një familje të madhe në Sll-ovë të Dibrës, që menduar se ardhmja do të ishte krejt ndryshe. Qe menduar kështu deri pas çlirim-it, kur emri i mirë i familjes u përplas me politikën komuniste. Elez Isufi (Ndreu) nga Dibra, i njohur si “Gjenerali me shajak” ishte një burrë në zë në Sh-

qipërinë e fillimit të 1900-ës dhe me njohje në rrethet patriotike të vendit si udhëheqës u kryengritësve që mbrojnë trojet shqiptare. Me vdekjen e tij, drejtimin e familjes e pat marrë i biri, Cen Elezi. Kulla e tyre në Sll-ovë të Dibrës vizitohej nga të huajt si Margaret Hazlett dhe familja e madhe vijoi luftën kundër pushtuesve në Luftën e Dytë Botërore. Megjithatë, me ardhjen e regjimit komunist, familja Ndreu nuk u pajtua me politikën që po ndiqte Enver Hoxha dhe

miqësinë e ngushtë me ish-Jugosllavinë. Komunistët nisën arrestimet, ndaj Cen Elezi me djemtë e tij dolën në male dhe u arratisën nga vendi. Pas lanë mes të tjerësh edhe Azizin, atëherë ende i vogël. Filmi nis me të (interpretuar nga Aldo Sheldija). Mandej shfaqen e ëma me motrat që nxirren me dhunë nga shtëpia e tyre, për t'u vënë në një kamion që i degdis shqiptarët, ku nis kalvari i vuajtjeve në kampet e internimeve deri në vitin 1990.


Me producente e skenariste Luljeta Prognin, regji të Gentian Kurtit e financim të fondacionit “Konrad Adenauer”, filmi merr si titull emrin e tij. “Azizi” u shfaq për herë të parë në kinemanë shqiptare të enjten, për të kujtuar vitet në kampet famëkeqe të internimit gjatë kohës së regjimit komunist. Ngjarja është një rrëfim i Azizit si i mbijetuar. Detaje të një historie rrëqethëse, internimi, torturat, ditët pa bukë, pa ujë, pa rroba janë pjesë e rrëfimit të tij. Kujtimet e Azizit, tanimë në moshë të thyer, hedhin dritë mbi jetën në kampet e Turanit, Tepelenës e Beratit.

Për gazetaren Luljeta Progni, producente e filmit, krijimi artistik është si i vetmi mjet për të kujtuar dhe për ta bërë shoqërinë të vetëdijshme për të shkuarën e saj të errët. Azizi, sot 86 vjeç, me të njëjtën forcë për të jetuar, e kujton atë kohë deri në detaje, me dhimbjen për të gjithë ata me të cilët vuajti e të gjithë ata që la pas. “Ndjehe shumë emocionuar dhe shumë i prekur nga kjo histori, por do të doja t’ju thosha edhe më shumë se kaq. Atë jetë, atë kohë, unë e kam gjithmonë para syve. Me detaje jam gati ta them gjithçka”.

Filmi tregon se në pranverën e vitit 1948, Azizi 14-vjeçar, bashkë me nënën dhe motrat dëbohen dhe dërgohen drejt kampeve. Mes skenave jepen edhe shifra dëbimesh e internimesh se si shpërnguleshin me dhunë nga shtëpitë e tyre mijëra familje, kryesisht fëmijë, gra e të moshuar, shumë prej të cilëve nuk u kthyen kurrë në vendlindje.

Mes tyre është Azizi që përjeton vdekjen e qindra fëmijëve prej urisë dhe sëmundjeve, humbjen e nënës dhe ngjarje të tjera të rënda që ndodhin çdo ditë mes të internuarve që mezi mbijetonin. Në kampin e Tepelenës, pas një aksidenti gjatë punës për transportin e druve në mal, Azizi shtrohet në infermierin për t'u kuruar dhe më pas emërohet ndihmësinfermier. Përparësja e bardhë i jep mundësinë që të jetë më pranë

vuajtjeve të të internuarve, duke i ndihmuar me sa mundet. Pas mbylljes së kampit, Azizi i mbeur vetëm, i përparësja e bardhë dhe vazhdon internimin larg vendlindjes edhe për 37 vite të tjera, deri në rrëzimin e regjimit komunist. Filmi përfundon me lindjen e djalit të parë të Azizit në barakë. Ajo që e zbeh peshën dhe klithmën që do të duhej të përcillte filmi, (me gjasë prej fondeve) është mungesa e skenave masive, mungesa e skenografisë e rindërtimi i ambienteve siç ishin në atë kohë kur të internuarit jetonin në to. Sfondi historik do të përcillej dhe do ta krijonte më të fortë gjendjen e ankthit, mjerimit, frikës, nëse personazhet do të ishin vënë në skenat e kohës, për t'i shtuar tmerrit që krijon vajtoja, vdekja e varrosja e fëmijëve, a vaji e cmenduria e nënës (Suela Bako) imazhin e kohës. Rindërtimi i kampeve siç patën qenë, bashkë me mbipopullimin me më shumë se 1000 të burgosur, me nga një batanije leshi, e me nga një kothere bukë; terrori i (disa) oficerëve që vrojtonin e dhunonin, që të rrihnin se merrje ujë, a vidhje fruta, do ta bënte filmin më të plotë në mesazhin e vet. Mes shumë skenave të mbetet në mendje ajo e uratëve, që në fillim të filmit shtrëngohen në duart e një nëne të moshuar, mandej nga një vuajtje e në fund shkojnë me lumin që ikën për në det. Udhëtimi i uratëve, duar me duar deri në lum, është domethënëse. Si lutja, para një dritareje me plastmas të grisur, por ku boshi i hapësirave të lë shijen e një skene të pandërtuar me shumë se sa të kampit që vizatonte Lek Pervizi. Filmi ia del të përçojë torturat komuniste, ia del të na tregojë të shkuarën dhe të tashmen. Kemi humbur rrezëz e shtëpi, por kemi humbur dhe kujtesën. Vetë kampet e lëna në rrënim, duket se kërkojnë të na lënë të harrojmë se ç'ishte. E pra nuk ishin magazina, veç në mos pranorimë se ne e magazinuam në ato kampe dhe harruam ta merrnim më.





E DIEL

28 Tetor

2018



NGA GJON MARKU

**T**radita letrare gojore, e cila është e lashtë te çdo popull dhe që lindi atëherë kur njeriu u bë i vetedijshëm për veprimtarinë e vet, u pasua nga një mënyrë tjetër, nga një traditë e re e krijimtarisë dhe ekzistimit të fjalës artistike dhe e komunikimit letrar - shkrimi. Fillimet e para të tij i gjejmë afro 4000 vjet para erës se re (para Krishtit). Por rrenjet dhe fillimet duhen kërkuar më herët se të dhënat dokumentare që disponojmë deri më sot. Vepra e parë letrare e botës që ne njohim deri sot është "Epi i Gilgameshit". Kjo veper është shkruar me një shkrim kuneiform (shkrim me kunjë) në pllaka dheu që më parë pëqeshin. Epi i Gilgameshit erdhi përpara lexuesve shqiptarë në vitin 1991, e përkthyer prej gjermanishtes nga Anton

# Ku gjenden bibliotekat më të vjetra në Shqipëri?!

Berisha. Kjo veper mendohet të jetë shkruar në vitet 3500 para Krishtit dhe është zbuluar në qytetin Uruk. Në afërsi të Babilonit (në jug të Bagdatit të sotëm). Të parët që e përdorën shkrimin me kunjë mendohet të kenë qenë sumerët. Po ashtu, në konkluzionet e nxjerra deri më sot, edhe vepra Epi i Gilgameshit mendohet se i perket traditës sumero-babilonase. Në shekujt më vonë ka lindur tipografia. Të gjithë librat e shtypur që nga lindja e ti-

pografisë e deri në vitin 1500 përbëjnë botime të veçanta në kulturën botërore, të cilat dallohen nga botimet e mëpastajme nga disa tregues si:

-Në keto botime mungon fleta ku vihet titulli dhe të dhënat e botimit, këto të dhëna jepen në mes ose në fund të librit.

-Gërma e parë e kapitujve të veçantë, por edhe ato të kryereshtit, në disa raste gjatë botimit lihet vendi i zbrazët dhe këto gërma shkruhen me zbulurime me dorë, por meqenëse shkrimi

dhe zbulurimet e këtyre gërmave kushtonte shumë, shpesh në këtë grup të librave këto gërma mungojnë.

Letra që përdorej për shkrimin e këtyre librave përgatitej me dorë.

-Shkrimi në këto libra është i ngjashëm me dorëshkrimin, ndërsa në botimet e mëvonshme ngjashmeria me dorëshkrimin vjen duke u larguar çdo ditë e më shumë.

Të gjithë librat që kanë karakteristikat e mësipërme dhe që janë

botuar para vitit 1500 janë quajtur Inkunabula. Tirazhi i vogël si dhe vjetërsia e botimit të tyre bënë që inkunabulat të jenë vepra shumë të rralla e me një vlerë të jashtëzakonshme.

Shtypja e librave që i takon periudhës derisa shtypshkrimi kristalizohet teknikisht mirë, njihet me emertimin e mësipërm -Inkunabulat-. Këtu nis edhe një moment i ri evolucionit, duke u larguar gjithnjë e më shumë nga modeli i dorëshkrimit.

→Vijon në faqen 14

Redaktor: Ben Andoni. 359

**Në këtë numër: GJON MARKU, KRENAR ZEJNO, KUJTIM DASHI, QAZIM SHEHU, BAJRAM SEFAJ ETJ...**



A

ARGUMENT

Gjurmët e para që paraqesin interes dhe që flasin për vende ku ruheshin dhe grumbulloheshin libra pa diskutim mbeten qendrat e mëdha kishtare. Kështu, në memorien historike mund të përmenden Shkodra apo Drishti, Kryepeshkopata e Ohrit, Metropolia e Prevezës dhe të Kosovës. Metropolia e Durrësit apo Episkopati i Elbasanit, të Apollonisë, të Vlorës, të Lezhës, Metropolia e Janinës, Episkopati i Gjirokastrës, të Drinopojës, të Himarës, të Butrintit, të Artës etj., të cilat zënë fill herët si qendra të mëdha dhe të përmendura kishtare dhe kulturore...

# Prej Gilgameshit, te Bibla Mazarin

(INKUNABULAT)

NGA GJON MARKU

Vijon nga faqja 1

S i libër i parë i shtypit në shtypshkronjë njihet Bibla e Guetenbergut, e emërtuar si e tillë nga shpikësi i shtypshkronjës Johanus Ganflajsh në vitin 1444, që më vonë u quajt Guetenberg nga emërtimi i shtëpisë ku ishte vendosur. Bibla e Guetenbergut është një libër me 635 fletë është shtypur në gjermani me një tirazh prej 180 kopjesh. Shkrimi në libër është një kombinim mes ngjyrash kuq e zi. Ky libër njihet edhe si Bibla Mazarinë pasi ajo është njëra nga veprat dhe ekzemplaret më të njohur që ruhen në bibliotekën Mazarinë të Parisit.

Formati është ½ me germa gotike që emitojnë germa të dorës. Ajo njihet si kryevepra e artit tipografik në botë. Brenda fletës shkrimi është bërë në dy kolona me nga 42 reshta.

Shpikja e shtypshkronjës në Magonc të Gjermanisë që një ngjarje e rëndësishme në historinë dhe zhvillimin e kulturës botërore. Për disa vjet rresht kjo shpikje u mbajt si monopol në Gjermani. Më vonë shtypshkrimi u përhap me shpejtësi edhe në vendet e tjera të europës.

Në viset shqiptare ngritja e shtypshkronjave daton në shekullin XVI-të. Në vitin 1563 përmendet shtypshkronja e Shtjefen Shkodranit në qytetin verior të Shqipërisë, në Shkodër. Por nëpërmjet burimeve shkencore hidhet dritë edhe për një shtypshkronjë të hershme në Obot të Shkodrës. Kjo shtypshkronjë përmend më së pari 1493, në shekullin XVII kemi shtypshkronjën e mirënjohur të Akademisë së Voskopojës. Kjo shtypshkronjë njihet nga ana jonë nëpërmjet botimeve të saj që në vitin 1714.

Sot në botë numërohen rreth 450.000 Inkunabula rreth 100.000 janë të sistemuara në bibliotekat e Italisë. Por ato janë të shpërndara në disa prej tyre. Në bazë të të dhënave të deritanishme, biblioteka më e pasur në botë me Inkunabula është ajo e Mynihut me 16.000 Inkunabula, pas saj vjen muzeu Britanik i Londrës me 11.000 të tilla.

Shqipëria fatmirësisht, në fondin e rrallë të bibliotekës kombetare ka shtatë të tilla, të cilat përbëjnë një thesar të pasur për të. Ato datohen në vitet 1473 deri në vitet 1479, duke u përfshirë në periudhën brenda vitit 1500. Duhet theksuar se në përgjithësi ato janë të pastuduara dhe të patrajtuara e për pasojë pak të njohura në vendin tonë. Në mes të këtyre Inkunabulave ka prej tyre të stolisura me dekoracione të mrekullueshme dhe me një harmonizim të ngjyrave të përsosura midis të kuqes, blusë, të bardhës, të gjelbrës dhe në ndonjë rast të rrallë të ngjyrës vjollcë. Nuk mungojnë stolisjet e tyre me ar. Por ato më të hershmet janë me dekoracione më të pakta. Ka prej tyre vetëm me dekoracione bardhe zi. Në fundin e njërës prej tyre gjendet sigla, simbol i tipografisë. Më me vlerë biles dhe më e studiuar konsiderohet ajo e



vitit 1472 e cila është një përmbledhje letrash Aeneas-Silvius Pikolomini (Papa Piu II) personaliteteve më në zë të vendeve të ndryshme të Europës. Midis tyre gjendet edhe një thirrje për organizimin e një ekspedite të gjerë ndërkombëtare antiosmane. Në këtë libër flitet edhe për Gjergj Kastriotin dhe për Pirron e Epirit. Natyrisht, kjo veprë është njëkohësisht edhe një burim i rëndësishëm historik për vetë faktin se në këtë periudhë burimet shkrimore janë të pakta. Ky liber është i shtypur me germa të tipit latin. Në germen e parë të kapitujve gjenden zbulime të shumta që e përkohjnë gjithë fletën nga kryet e deri në fund. Arti i të zbuluarit janë edhe zbulimet e shumta dhe dekoracionet e mrekullueshme të artit të harmonizuara me sfondin shumëngjyresh, të vendosura në pjesë të veçanta të kapakut të librit. Libri ka gjithsej 179 fletë ndërsa në fletën e fundit të tij është e vendosur edhe data me shifër romake, e cila përkon me datën 25 maj 1473. Duhet theksuar se kopertina e librit nuk është e plotë pasi ajo është dëmtuar.

Duke parë këto thesare të bibliotekës sonë kombëtare, mendja të shkon menjëherë tek

## Përpjekjet për shqipen

Përpjekjet për gjuhën shqipe nuk pushuan asnjëherë. Në shekullin e XVI, në fillimet e tij, megjithëse në kushte shumë të vështira, sidomos prej izolimit dhe pushtimit turk dhe prapambetjes së madhe ekonomike, pati klerikë të fuqishëm e përparimtarë mirditorë që predikuan në gjuhën shqipe, shkruan dokumente të rëndësishme në gjuhën tonë. Njëri prej tyre ishte edhe Shtjefën Gazulli, i cili nënshkroi tri kontrata për shitje toke nga disa oroshjanë në fillim të shekullit të XVII

Pal Engjelli.

Datimi i të parit shkrim shqip, shkrimi i të parit libër shqip apo dhe gjetja në portën e një Abacie të vjetër e fjalës kombëtdhënëtur në mermer që në 1100-1216 të bën të mendosh motoja e luftës për komb, atdhe e fe kishte udhëhequr klerikët që së hershmi. Kryepeshkvi i Durrësit, Imzot Pal Engjelli- Ky jeto i në 1417-1470, i cili hyri në historinë e kombit tonë si bashkëpunëtor i të madhit Gjergj Kastrioti, ky prelat i madh i kishës katolike shqiptare, gjatë një vizite baritore në Mat (Emathia), vuri re çrregullime të mëdha në punët dhe në vepërimtarinë fetare. Me këtë rast, më 8 nëntor të vitit 1462 nënshkruan në kishën e Dukagjinit të Mat Formulën e Pagëzimit, që më vonë do të rezultojë si dokumenti më i vjetër i shqipes së shkruar. Fraza shqip gjendet në një letërqarkore në latinisht. Un të pagësonj pr' emojt Atit e t'Birit e t'shpertit Shenjt. Ky prelat i kishës katolike në atë periudhë kishte nën juridiksionin e vet edhe famullitë e Matit dhe dioezat e kësaj krahide. Ajo u shkrua për të ndihmuar banorë të krahinave të largëta që banonin nën vështërsi dhe mungesë të

veprave të kultit të cilat pas kësaj mund t'i pagëzonin fëmijët në shtëpi, nëse për shkaqe të ndryshme, nuk kishin mundësi t'i çonin në kishë. Kështu gjejmë të parin dekomment të shkruar të gjuhës sonë amëtare i cili formulohet natyrshëm në dialektin Gegë. Njoftimin e parë për këtë dekomment e bën studiuesi dhe historiani rumun Nikolla Jorga, i cili e botoi më 1915. Duke ndriçuar e duke hedhur vështrimin te shekujsh në gjuhën e dokumentuar dhe në kulturën tonë kombëtare. Më pas vjen i pari libër në shqip nga një tjetër klerik pra nga Gjon Buzuku.

Por le të kthehemi një moment më përpara te Inkunabulat të cilat nuk janë plotësisht të studiuara nga specialistët e për pasojë nuk gjendet një informacion i plotë dhe i mjaftueshëm për tonë mënyrë të veçantë në vendin tonë.

## NË GJURMËT E BIBLIOTEKAVE

Sa herë flitet për bibliotekë dhe lulëzim të tyre gjithkujt i shkon mendja tek njëra ndër bibliotekat më të famshme dhe më të njohura ndër të gjitha kohërat pra tek Biblioteka e Aleksandrisë e cila ishte jo vetëm një bibliotekë e famshme ashtu si dhe Aleksandria por dhe një qendër e krijimtarisë, kulturës, dijes dhe tolerancës. Aleksandria u zgjodh prej Aleksandrit të madh si kryeqytet i perandorisë së tij në vitin 320 para erës së re dhe shumë shpejt u shëndërrua në qytetin më të fuqishëm dhe më me influencë në rajon. Biblioteka originale e Aleksandrisë u themelua më 288 para erës së re nga Ptolomeu I. Ajo ishte njëri ndër tempujt më të mëdhenj që ka njohur historia të mendimit dhe funksionoj si akademi, qendër studimi dhe bibliotekë. Kjo bibliotekë ishte e vendosur në rajonin mbretëror të qytetit. Nuk është krejtësisht e qartë se kur u shkatërrua biblioteka e Aleksandrisë. Mendohet të jetë dëmtuar nga zjarri gjatë pushtimit të Jul Cezarit në vitin 48 para erës së re dhe gjatë ekspeditës ushtarake të Aurelit në Vitin 272 të erës së re. Në vitin 391 u dogj edhe ndërtesa në Serapium çka shënon dhe fundin e këtij Institucioni. Ndërtesa në Serapium ishte një bibliotekë e quajtur bije e bibliotekës së Aleksandris dhe ishte e vendosur në lagjen me





...nga numri i shkuar

"Milosao" e këtij numri ndahej në ballinë në dy argumente shumë interesantë. I pari lidhej me "Lutjen" e Gazmend Lekës, një ekspozitë me një argument për "Lutjen", aktin e shenjtë që lidhet me para-punën, që duket pak si akt sublim. Autori i shkrimit, në këtë rast redaktori, bëri një abstragim dhe mendon se ky akt zhvillon idenë për një "lutje" të gjithë shoqërisë në këtë kohë krize të frikshme. Me konceptin e "Lutjes" do të na vinte më mirë ta identifikonim jo thjesht ekspozitën e fundit të Gazmend Lekës, që qëndron e hapur te FAB prej ditësh, por grishjen që e gjithë shoqëria jonë duhet të bëjë para verdikteve të mëdha, theksoi ai. Për fat, u mirëkuptua nga autori dhe pak njerëz, që po e përjetojnë këtë kohë krize të pafund.

Avni Alcani na solli argumentin e dytë, që kishte të bënte me një ngjarje të vitit 1938, koha kur zoti Shahin Zhari (1915-1991) nga Bërzeshta e Librazhdit, botoi në revistën "Shkolla Kombtare" (Nr. 16-17, faqe 22) këngën historike me titull: "Kanga e Gjoçq Golemit, Princit të Sopotit", e cila i kushtohet një prej figurave më të shquara historike të shekullit të 15-të, Princit Gjergj Aranit Komnen Golemi, Zotit të Çermenikës, Mokrës dhe Sapatit. Një shkrim, që edhe pse shumë teknik mbetet jetë interesante për të njohur pjesën tonë të folklorit. Autori është zakonisht i pakënaqur me redaktorin, por këtë herë u mofuata me fjalë të mira kortezie.

Shkrimtari dhe studiuesi Arian Leka dhe përkthyesja dhe studiuesja Silvana Leka

morën pjesë në Panairin e Ndërkombëtar të Librit në Mal të Zi, ku referuan në një panel për letërsinë për fëmijë, një fushë që duket se i intrigon tashmë dy personazhet tona që janë dhe botues të njohur.

Haili Rama përcolli një ndërimit për shkrimtarin shqiptar, që ndërroi jetë dy vjet më parë. Teodor Laço dhe paraqiti dhe korpusin e tij letrar, që përfshinte mëse 50 tituj romanesh, vëllimesh me tregime, dramash, komedish e kujtimeve, duke e vlerësuar me shumë superlativa. Për fat të keq, ideologjizimi i një pjesë jo të vogël të krijimtarisë së tij, bie pak ndesh me mendimet e shprehura nga autori, në mendimin e redaktorit.

Mimoza Kouchny erdhi me një tregim të këndshëm, që mund të ishte kuruar pak më thjesht, pa nevojën e ndërhyrjeve. Dhe, në fund, pati vend edhe për Ambasadorin Polak në vendin tonë Karol Bachura, që shkroi diçka në nderim të 25 vjetorit të vizitës së parë apostolike në histori të Atit të Shenjtë Gjon Pali II në Shqipëri si dhe viti i 40 vjetorit të zgjedhjes së Polakut, kardinalit Karol Wojtyła (Karol Wojtyła) në Selinë e Shenjtë-Papës së parë jo-italian në më shumë se pesë shekuj. Mund të themi se ishte relativisht një numër i mirë dhe i rregullt, por që mbase duhej të kishte pak më zhdërvjelltësi. Layout, kishte gabuar shumë me emrat sllavë dhe për fat të keq ende nuk di t'i përçojë ato në botim.

të njejtën emër të qytetit.

Kjo ishte një bibliotekë e vendosur në brigjet e Detit Mesdhe në udhëkryqin midis Europës, Azisë dhe Afrikës duke gjetur pikën kyçe për të vendosur bibliotekën më të madhe të botës antike.

Por le të kthehemi në vendin tonë ku Shitimi i numrit të librave dhe botimeve kishte bëri të domosdoshme ruajtjen dhe administrimin e librit kështu nisim jetën e tyre bibliotekat. Prania e tyre në vendin tonë është e lidhur padiskutim me lashtësinë e gjuhës dhe me lashtësinë e kulturës sonë.

Nëse flasim për gjuhë të shkruar shqipe atëherë dëshminë e parë për një gjuhë të shkruar na e sjell letra e një peshkopi francez në Tivar, Guliem Aadae i mbiquajtur Brokard. Në këtë letër të datuar në vitin 1332 Brokard njofton mbretin e Francës, Filip de Valua se: "Shqiptarët flasin një gjuhë tjetër që ndryshon nga Gjuha Latine në të gjithë librat e tyre" Kjo do të thotë se gjuha shqipe kishte filluar të përdoret gjerësisht si gjuhë e shkruar.

**PO KU JANË GJURMËT E PARA PËR BIBLIOTEKAT NË VENDIN TONË?**

Gjurmet e para që paraqesin interes dhe që flasin për vende ku ruheshin dhe grumbulloheshin libra pa diskutim mbeten qëndrat e mëdha kishtare; Kështu në memorien historike mund të përmenden Shkodra apo Drishti, Kryepeshkopata e Ohrit, Metropolia e Prevezës dhe të Kosovës. Metropolia e Durrësit apo Episkopati i Elbasanit, të Apollonisë, të Vlorës, të Lezhës, Metropolia e Janinës, Episkopati i Gjirokastrës, të Drinopojës, të Himarës, të Butrintit, të Artës etje të cilat zënë fill herët si qendra të mëdha dhe të përmendura kishtare dhe kulturore

Në mesjetë kur manastret janë kthyer në qendra kryesore të kulturës dhe dije, ndër to nis dhe grumbullimi i librave dhe formimi i bibliotekave.

Kështu që gjurmët e para të bibliotekave të organizuar i gjejmë në shekullin e XII-të, në fillimet e tij, në atë kohë kur Papa i Romës, duke dashur të rrisë influencën e selisë së shenjtë dhe të forcojë kishën katolike në Shqipërinë e Veriut, vendosi theme-

limin e disa kuvendeve e manastireve të cilët më vonë qenë qendra të rëndësishme për pregatitjen e klerikëve. Kështu, në krahinën e Mirditës së mëvonshme (themi Mirditës së mëvonshme sepse Mirdita është formuar si unitet krahinor vonë) u themeluan në fillim të shekullit të XII-të kuvendet benediktine të Shpalit (në Pshqesh), Shën Mëria e Ndërfanës (në Gëziqin e sotëm), të Shëlbuemit (në Rrubik) dhe të Shën Llezhdrit (në Malin e Shenjtë në Orosh)(3).

Autorë të huaj kanë shkruar jo pak për këto Abaci të Mirditës, mes të cilëve dhe Shuflai i cili pohon se: "më në jug fare ndër gjendet shqiptarë, ndërmjet lumeneve të dy Faneve, në krahinën prej nga në të XIV shekull delshin priftërinj për krejt Dalmacinë, gjendeshin Abacia e Shën Palit dhe Santa Mëria di Trifantina. Kjo e fundit qëndroi si e tillë deri në të XIIV -in qindvjeçar (4).

Është pikërisht koha kur arsimi, libri dhe kultura është plotësisht në duart e klerikëve dhe lëvizja kishtare filon të marrë karakter të theksuar kombëtar (5).

Mirdita me shtrirjen e saj në qendër të Shqipërisë së Veriut ishte një urë-lidhje në arterjen kryesore lidhëse në mes të lindjes e të perëndimit. Pra,

**Veprimtaria bibliografike në Shqipëri**

Nëse flasim për bibliotekat si vendi i ruajtjes së librit, atëherë njëra ndër elementet më të rëndësishme ku mbështetet biblioteka janë punimet dhe studimet bibliografike. Këto punime në vendin tonë i gjejmë së pari në shkrimet e botuara nga prof. Dhimitër Shuteriqi dhe nga prof. Jup Kastrioti në shtypin periodik të kohës në vitet 1944.

Në Bibliotekën Kombëtare është Aldo Çoba, i cili në vitet '50 bëri përpjekjen e parë për hartimin e bibliografive për librin shqip. Në vitin 1958 u botua Bibliografia Kombëtare e Librit që botohet në Republikën e Shqipërisë.

Sot janë të shumta bibliografitë dhe sistemi bibliografik funksionon në një mënyrë mjaft të specializuar.

duke e parë si një nyje jashtëzakonisht të rëndësishme Papa merr vendimin për ngritjen e këtyre kuvendeve të mëdha në Mirditë.

Gjithçka fillet në dokumentat e studjuesve perendimorë për periudhën përpara pushtimit turk të Shqipërisë flet për lulëzimin e një kulture të mirfilltë europiane e të një niveli të lartë arsimor, aq sa në Shqipëri siç pohon Shuflai pregatitshin klerikë për krejt Dalmacinë, madje dhe për Raguzën (6).

Pushtimi i gjatë turk nuk mundi të asimilojë kulturën e lashtë të popullit të Mirditës, po ashtu asnjëherë nuk mundi të nënshtrojë atë, pasi mirditasit nuk i lëshuan kurrë armët nga dora. Megjithatë ky pushtim i gjatë goditi fuqishëm jetën kulturore e arsimore të Mirditës ashtu si dhe të mbarë Shqipërisë. Fushatat dhe sulmet e njëpasnjëshme të turqve mbi Mirditën bënë që së pari të shkatëroheshin nga themelet Abacia e Oroshit dhe kuvendet e tjera benediktine. Duke folur për rrënimet e kishave katolike prej turqve, studiuesi Pal Doçi, në mes të tjerash shkruan se "Qysh nga fundi i shekullit të XV-të dhe gjatë shekujve të XVI-XVII-të qenë rrënuar e qenë goditur

disa herë nga pushtuesit turq (7) Pra sulmet turke bënë që të mbyllet Abacia e Oroshitit e të mos funksionojë për një kohë të gjatë (8).

Përpjekjet për gjuhën shqipe nuk pushuan asnjëherë. Në shekullin e XVI-të, në fillimet e tij, megjithëse në kushte shumë të vështira sidomos prej izolimit dhe pushtimit turk dhe prapambetjes së madhe ekonomike pati klerikë të fuqishëm e përpërmartarë mirditorë që predikuan në gjuhën shqipe, shkruajtën dokumenta të rëndë-

një qerre e madhe e tërhequr me qe, e ngarkuar me dorshkrime, libra dhe dokumenta historike si kapërceu vështërsit e balta të Zadrimesë në mbyt "aksidentalisht" duke kaluar Drinin. Së toku me të treti e gjithë ngarkesa e Cmuar.

Të gjithë flasim dhe kërkohet të gjejmë gjurmët e bibliotekës së Abacis së Vonë të Oroshit. Dom Lec Sahatça flet në shkrimet e veta për një bibliotekë të Ndërfanës madje për një bibliotekë të pasur të kësaj kishë vonë



në 1944 kur ai deklamon disa shkrime të ti të njëpasnjëshme për Blinishtin.

Por le të shohim më gjerë mbi gjurmët e bibliotekave të tjera jashta Mirditës. Dihet dhe është e dokumentuar ekzistenca e një bibliotekë në Voskopojë ku kemi pasur dhe një akademi në 1744.

Është folur e shkruar për biblioteka familjare të familjes Frashëri.

Biblioteka e familjes së Lef Nosit, të familjes Vlora etje në një kohë që kemi botime të jashtëzakonshme dhe të parritshme nga franceskanët. Koleksione të tëra revistash.

Për të ardhur në 1912 kur në Shqipëri filon një veprimtari bibliotekare publike për të mbërritur në vitin 1922 në themelimin e bibliotekës së parë shtetërore kombëtare. 10 dhjetori i vitit 1922 hyn në historinë e vendit tonë si data e themelimit të bibliotekës kombëtare e cila është dhe biblioteka qendrore dhe kryesore në vend. Si bërthamë e kasaj bibliotekë ka shërbyer biblioteka e Komës së Letrës shqipe e krijuar në Shkodër në vitin 1917.

Në fondin e kësaj bibliotekë tash ruhen libra të vjetër të botuar deri në shekullin .XVIII, shtatë incunabula, libra të rrallë e dorëshkrime të vjetra me vlerë. Ky fond ruan në origjinal veprat e para në gjuhën shqipe, botimet e shekullit XVII të Pjetër Budit, Frank Bardhit e Pjetër Bogdanit, veprat e humanistëve shqiptarë të shekullit XVI Marin Barleti e Marin Bëçikemi etje. Ndonëse në fotokopje me vlerë për fondin e antikuaresve janë libri i parë në gjuhën shqipe "Meshari i Gjon Buzukut (1555)dhe "Embësue me krishterë" e Lekë Matrëngës (1592)

Biblioteka Kombëtare ruan në fondin e vet edhe disa nga botimet e shtypshkronjës së Voskopojës (shek XVIII). Kjo bibliotekë u bë faktor në krijimin e bibliotekave të tjera satelitore.



T

TREGIM

Autori sjell një realitet të ditëve tona me personazhe gati reale, duke na afruar me paradokset e kohës ku jetojmë...

# Pas Guttenbergut, një filxhan çaj me kamomil

NGA KUJTIM DASHI

MASTERXHIKU I GJYSHES, siç i pat thënë ajo si me përkëdheli, që në krye të herës, duke aluduar e, në të njëjtën kohë, si përherë duke ia bashkëlidhur nga pas si rimorkio masterit edhe mbiemrin e njërit më me autoritet shkencor prej aq të njohurve e miqve të familjes a më shumë të të atit, që e kishin udhëhequr e mbështetur për përgatitjen e temës, ditën që nipi e hoqi qafe dhe mbrojti temën e masterit, prej disa kohësh e kishte prishur rregullin e përpiktë të kthimit në shtëpi fill pas mbarimit të orarit zyrtar. Gjyshja e priste në dritare dhe, sa e dallonte nga larg, që kapërcente urën e Lanës, atë të këmbësorëve, te ish-ekspozita "Shqipëria sot", ngrihej vrik për t'i përgatitur drekën. Këtë ritual, te cili çuditërisht gjente përherë e të ripërtërirë atë kënaqësinë e veçantë dhe të pashtershme të përmblotjes së përpiktë të detyrës së gjyshes amvisë, kishte ndjekur për të shoqin, dritë pastë, për të birin, që bënte pushimin e drekës me të shoqen në dhomën e gjumit matanë, si pensionistë të ngëshëm, tani dhe me nipin, mjaltnin e mjalitit, se mbesa që martuar e kishte shkuar në shtëpi të vet.

Fluturonte teksa i bënte gati gjithçka thuaje në mënyrë manualistike, sikur po filmohej nga ndonjë kamerë e, ndërkohë, bisedonte në ndokënd nëpër kuzhinë, duke i rrefyer, se si mund të shtrohej një tryezë, kur thoshte me vete, bie fjala, supën e futa në mikrovale; lugën, pirunin e thikën i mora; sallatën të pres si e do djali, se atë e bëj shpejt e shpejt; të nxitoj për të ngrohur gjellën në furrën dhe mikrovale, dhe tekja e rakisë ja tek është, apo mos ka pirë edhe sot, derisa në fund shqiptonte e lehtësuar dhe e qetë frazën "Hë, tashti gjithçka gati, të bëftë mirë, o bir!" Dhe ulej në divan të shlodhej, kundronte veprën e përfunduar dhe herë lexonte librin e radhës, pa u përqëndruar si në orët e tjera të ditës. Qejfi i saj ishte t'i hapte derën e shtëpisë pa i rënë ziles; aty në mesore rrinte e priste ndoshta për minuta të tëra, sa i ndjente hapat e këmbëve deri në shkallën e fundit dhe, ndërkohë që nipi matanë ngrinte dorën për t'i rënë ziles elektrike, kur ajo fap sakaq ia hapte derën, sikur po i bënte një surprizë a lojë. Oh, si ngazëlleshje, si ta kishte premierë çdo ditë këtë farë robotizimi, ndërsa atij s'i bënte më përshtypje kjo lojçakëri pleqërore, të paktën jo më si dikur, kur nisi ky ritual. Çante përpara në mesore, duke lëshuar një mërmërimë të mbytur, si miza në gyp. Gjyshes i bëhej sikur i thoshte mirëditë.

Pastaj në divan, përkundraill tryezës të shtruar, ulej gjyshja, së cilës i vinte mirë të hiqej naivisht sikur s'dinte gjë, se kush e kishte shtruar tryezën si në më të mirin restaurant, që për nga rregullsia, pastërtia e asortimentet e shtruara, mund t'i vije përditë vetëm notën dhjetë. Pyetje s'bënte më, qyshse nipi, një ditë, kur gjyshja kishte pikasur ndryshimin për të keq tek ai dhe ia kishte vënë në dukje me marifet, pa pritur t'ia çonte fjalën me ndokënd, nipi shfreu

rëndshëm sikur s'kuptonte se kujt po i fliste ashtu, kur i tha "As me hëngër bukë s'më lini?! Në zyrë na zien koka nga punët, këtu të shpjegoj hollësisht se çfarë kam bërë tetë orë atje. Të ha njëherë, se këtu më ke për hetuesinë tënde, mos ki merak".

Tani gjyshja pyeste a përgjigjej telegrafisht vetëm për pyetje të rëndomta, të reduktuara aq sa me thanë njeriu që jam gjallë e përballë teje, pyetje thjesht adresore, se ku është ai apo ky nga të shtëpisë dhe kaq ishte caku i saj, kordonin e së cilës ia kishte vënë po nipi. Dhe për motin e kishte pak a shumë si më të lejuar të thoshte ndonjë gjë, - shkakun e dhimbjeve të shtatit, - ose lërimin e temës së kotësisë, siç i thoshte gjyshja. Ajo e nuhaste, që kush hidhej degë më degë, për të llafosur për motin e merrej gjatë me të, donte të treste muhabet si njeriu që humbet udhën; donte ta lehtësonte barrën e tij, shkurt ta kotësonte atë si për të t'i thënë se së bashku vetëm për shiun a erën a diellin përvëlues mund të llafosemi rehat, vetëm kaq. Po edhe mbi këtë rregull, prapëseprapë gjithçka varej nga humori i të nipit.

Ai cangaca po merrte një hije të rëndë, përtej asaj që mund të ndodhte në moshën e tij, sikur të mos ishte thuaje në fillim të karrierës nëpunësore, por diku andej nga fundi, i strapaçuar dhe i neveritur nga puna shumëvjeçare rutinore zyrtare, të cilën, natyrisht, s'mund ta linte dot pa i marrë dhe frutin më të fundit, pensionin e majmë. Edhe brenda hijes së rëndë të të nipit, sikur kishin përzgjedhur pikërisht atë dhe po i vinin përditë gurë të rinj mbi barrën e tërë shtetit, kishte depërtuar vështrimi i mprehtë, syçellët dhe i ngëshëm i gjyshes, nga duart e së cilës kishin dalë qindra e qindra nxënës.

Nipi pothuajse ia kishte arritur t'ia ndalonte që ajo të nëpërmentte, se në mes të këtyre ish-nxënësve të saj disa syresh qenë bërë ministra, shkrimtarë, shkencëtarë, artistë, njerëz të dëgjuar. Ehu, pse nga fillorja jote u bënë të tillë ata? kish qëlluar pa dhimbje një ditë mu në shenjë krenarinë e jetës së saj, sikur të mos e dinte nipi se gjithçka ka një themel, se që të kalosh vaun e një lumi vërtet vë këmbën mbi gurin e fundit mbi ujë, po poshtë tij, ama, ka plot të tjerë, që e mbajnë atë... S'besoj ta kesh harruar, - fundja vetë na ke pasë thënë, kur u ktheve nga Italia, - se në katalogët dhe albumet e tij Ibrahim Kodra i madh nuk harronte kurrë të shkruante se e kishte nisur pikturën si nxënës i Odhise Paskalit tonë. Mirëpo mendjemadhësia e nipit ia kishte errur aq sytë, sa pandehte se gjyshja kishte lexuar tërë jetën vetëm ditarët e saj mësimorë, që

përgatiste çdo ditë! As se kishte qenë mësuese e merituar, s'i hynte në sy. Në kohën tuaj titujt merreshin qesim, nëna! ia kishte gjetur shpjegimin. Me biografi të mirë, ë? e ironizonte ajo. Tëpkë! O pleqëri, o dreq, që s'më jep më kohë për tim nip që ta ndreq, përsh-taste gjyshja.

Nëna vetes po, ia kishte thënë si një të fshehtë, askujt tjetër, nipi dukej se ditë për ditë po trukonte mbi fytyrë një maskë të përsosur; përhumbësin mendimtar e hallelshumë, që me marifet di dhe bën çmos që t'i mbajë sa më larg vetes të tjerët në një distancë të panevojshme e të përlogaritur me saktësi për secilin, madje edhe i përcmonte ata. Njerëzit, nëse donin, mund të mësonin ndonjë gjë rreth tij, vetëm çfarë t'iu ofronte ai dhe, absolutisht, asgjë tjetër. Mjeshtëri, edhe këtë titull mund t'i jepje, - mjeshtëri i fshehtësë së paditurisë, i dembelizmit, po dhe i vetëkënaqësisë intelektuale e i mbivlerësimit të vetes, kur e shihte se ç'njerëz e rrethonin a me kë punonte.

Gjoja tejlodhja, ndrydhja e qëllim të vetvetes si njeriu mendjemadh, që krijon enkas një distancë fiktive e alibike dhe, duke rreshtuar veten gjoja te elitarët, ngaqë puna ia donte të merrej me ta në një mënyrë a tjetër, s'denjon të dialogojë me dokedo, heshtja a ajo shtirje në shprehjen e fytyrës e në sjelljet e tij, për të krijuar te të tjerët përshtypjen e rreme se ky e shkoka tërë jetën, duke përasiuar mbi botën e mbi libra, duke studiuar dhe që hiqet sikur po sakrifikon shumë, duke jetuar në këtë vend të mallkuar që s'do të bëhet kurrë, gjyshes i dukej si diçka e sajuar, e trukuar dhe e kalkulluar me një ustallëk të përsosur. Ajo nuk i quante fantazira ato çfarë i dëgjonin veshët, po gënjeshtro të të nipit, gënjeshtro ditën për diell dhe pa ia patur nevojën. Ç'doktoraturë ke mbrojtur në Spanjë, mor djalë? Ti veç sa shkove në një special-



izim dyjavor, - rroftë sebepi, a kushedi si shpërbllim për ndonjë punë, që mund t'u kesh kryer shëfave, - i cili ishte udhëtim gati turistik, me atë çupkën, a grua ç'ishte, kolegen tënde. Me kë kujton se flet, kur u thua kështu njerëzve, me ndonjë çoban të qëmotit, që zbrret një herë në gjashtë muaj në qytet?! Kështu del sikur ke bërë mastera në çdo shtet ku ke kaluar tranzit për të shkuar në Spanjë, pra edhe sa mastera të tjerë ke?!

Ca burra vërtet e kanë për zanat të kthehen turivarur në shtëpi, po ama kur i pret ndonjë grua xanaxare që ia di huqet, se për ndryshe të shkojë i qeshur, duke kënduar a çakërçej, ditëzeza grua, do të mendojë, se i shoqi paskësh bërë qejf, kushedi me kë ka qenë deri tashti, e bren dyshimi e kësisoj muhabetesh e hamendimesh, por nuk vihet kështu në shtëpi të prindërve, mor bir, është njësoj si të mbjellësh ankhin te ne me duart e tua, të rrimë gjithë ditën e gjatë me zemër të ngrirë se qysh e tek po na kthehesh nga puna, i kishte thënë me të mirëgjyshja, ditën që thuaje nipi me sjelljen e tij extra me nënën ia ndaloj thuaje fare ta pyeste për ndonjë gjë nga ato të punës ndërkohë që drekonte. Se për kohën tjetër rrallëherë gjente një minutë të lirë, për t'u llafosur me hotelx-heshën e shtëpisë, ose me zyrën e adresave, siç vetëshpottij gjyshja, për të marrë vesh të tjerët, sidomos nipi, po dhe ato që ia kishin bërë kokën, pra, *prindërit biologjikë të tij*, pasi qenë pajtuar me statusin e vetmarrë e me sjelljet e tij si një shëf i madh dhe hallelshumë në shtëpisë e vet, ngaqë po përparonte shpejt në karrierë më shumë se kushdo tjetër nga rrethi farefisnor, madje edhe se versënikët e tij.

Po, kohëve të fundit, qysh se e kishin graduar të *djathët e majtë*, që ajo nganjëherë bënte gjoja se e shqiptonte jo korrektshtëm në *djajtë e majtë* - ti diçka iu ke bërë ose iu bën, mor bir, ma ndjen zemra, se ata kot, - i njoh mirë se çfarë malli janë, sidomos kreu i tyre, - nuk të bëjnë ty kaq të madh, drejtor të madh fare në këtë moshë që ke ti, nuk ta japin ty tërë atë rrogë e rrugë përjashta kaq të shpeshta e më the e të thashë; ata kanë shokët e tyre; kanë nipa, mbesa, dhëndurë, bashkëfshatarë; kanë të vetët, a më kupton? ata që kanë para shumë më tepër se ti, për të blerë një vend pune, siç po na dëgjojnë veshët përditë, kishte thënë gjyshja me frikë në shtat, pasi i kishte mbetur gozhdë në zemër, se mos ai kishte kryer si haraq ndonjë shërbim ekstra a kishte shitur lirë të shëfat e vet të rinj ndonjë koleg të punës, të cilin e kishin hequr nga administratë, për të siguruar vendin e vet, pas shkurtimeve më të fundit, kur ata, pas një rotacioni të dyshimtë e tepër të







diskutueshëm, rikërcyem në pushtet *me lule*, pasi më parë ishin hequr qafe *me kallashnikov*, - shpesh herë si ia shtronte tryezën, ashtu dhe e mblihdte prapë drekën, pa zënë gjë me dorë dhe ajo bëhej keq, pikë e vrerë. Dhe jo vetëm përse nuk hante.

Po si një ditë, përditë kështu. Oreksi teposh-të, - kam ngrënë jashtë; isha me ca shokë; patëm një seminar me të huajt; isha në një pritje, ç'qejf që bëmë, si gatuhet atje, nëna ty vetëm patate të lënë të qëros; më erdhi një mik nga rrethet e ai s'të lë kurrë me fut duart në xhep ngaqë i kam bërë një të mirë, të shkretit, që s'ma harron kurrë, - e shëndeti terminal, ç'është kështu, mor bir?! Qe shëndoshur, sa me ia drashtë tërë atë shëndet, se për gardërobën që rinovote s'bëhej kush më merak.

Rroga e majme dhe ç'rënditje prej projekteve, që fitonte ripërtërinin çdo ditë gardërobën. Gjyshja e ngacmonte dhe i thoshte *Mjeshtri i madh i projekteve!* Shumicën e gardërobës e porosiste në internet dhe ia sillte posta nga jashtë në shtëpi, aq sa ngjalli edhe kureshtjen e fqinjëve për pakot plot vula e mbishkrime, që merre tashëparë nga jashtë. Për ca kohë u gjenden ngushtë, se nuk kishim më as profesionale për ta krahasuar shëndetin e tij, që ta vinin medemek në sedër djalkën, si kasap, kuzhiner, deputet...Mos o zot, deri te derri, te derri lladik. E ka nga mërziçia nëna, e justifikonte e ëma, e cila ia kishte gjetur kryeshkakun. Ishte koha, kur asaj i duhej të bënte sytë qorr e veshët shurdh deri në zënie me presh në dorë...

Pas një telefonate urgjente në celular, - i qenë lipsur shumë ditë gjurmimesh vetjake e në një konspiracion të thellë nga dyshimi i parë i saj, - e kishte çuar me dorën e vet të birin, mu te dera e apartamentit, ku flirtonte e fejuara me shefin e saj. Eh, ato ditë e kishin plegëruar dhe do të ndanin ditën e dasmës; do ta merrnin nuse në shtëpi dhe ajo... Ja, ku e ke, dje bëtë celebrimin, sot i ka hipur tjetri përsipër si përditë, po ti nuk doje kurrësesi të na besojë. Ja, ku i ka ngritur këmbët përpjetë, me dritare hapur, përballë pallatit, ku kanë vënë portretin dhe sloganin tënd të famshëm të fushatës elektorale "Unë guxoj!". Guxo tani, o haje turpin, o ndaje, rrugë tjetër nuk ke! Dhe, ti mori zoti mendte e kresë, po o more, kjo jo vetëm s'fut as majën e gishtit brenda, po në shtëpinë tonë s'ka më vend as për ty, absolutisht. Do t'i vë zemrën një gur; pata një djalë, tani s'e kam më...Unë e bëra detyrën time si nënë, tani ti bëje tënden si burrë, si djali im.

Kollaj të kesh në fushatën tënde elektorale, - paqka se nuk arrite të fitosh e të dalësh deputet i partizës tënde, - sloganin "Unë guxoj"! Tani të erdhi çasti të guxosh vërtet. Tregojë veten! Nuk e shikon se ç'appartament ka

zgjedhur për të të sfiduar dashnori që të shkërdhejë të dashurën tënde, nusen e shtëpisë sime e të djalit tim të vetëm? Mu përballë pllakatit tënd që ka veshur tërë fasadën e pallatit, me fytyrën tënde e sloganin tënd "Unë guxoj". Zot ç'mëndje diabolike e përtallje të kanë bërë?! Përplasja për kokë kamerën dhe gjithçka kanë xhiruar deri më këtë çast...Do të të bëjnë shantazh me të nesër, ke për të parë...

Masterxhiku i tronditur si t'i kishte rënë rrufeja në qiell të pastër, vendimin e mori në vend pa ndonjë tradnje në njeriu që e ndjen se një ditë gjithësesi do ta marrë hakun për atë që ka bërë a vazhdon ta bëjë vetë në krahuin tjetër po incognito. Vendimi ishte paraprak a i nënkuptuar si për çdo burrë që i ka topet në rregull e mendtë në kokë, sapo ia mbërriti policia dhe i zunë brenda dy dashnorët si mos më keq. Po vendimi pati dhe një fazë tjetër, atë përfundimtarin, shpërfajton publikë, që lidhej edhe me se e si do të shpallej *mënxyrva*.

Masterxhiku e peshoi mirë e mirë dhe e mori vendimin, vetëm kur ia komunikuan detyrën e re dhe funksionit të tij i situat kaladibrance edhe tre sektorë të tjerë. Sipas përllogaritjeve të veta precize, u sigurua nga të gjitha anët, se paskëtaj nuk mund ta gjente ndonjë e keqe nga akti i tij *trimëror* para faktit të kryer. Pat nga ata, që kur e përhëndetën për vendimin, i thanë se kish të erën me vete, pasi e favorizoi edhe një situatë e pazakontë, i skandalit seksual të një ministri në një diktaster tjetër. *Njeriu i Shpresës së Bjerrun*, si lider rekordesh në not, ngjijtje maja malesh...e kishte shkarkuar ministrin për katër minuta, pasi kishte parë skandalin në një emision televiziv investigativ e humoristik. Nga ana tjetër, masterxhikut finok i dukej se aktin e tij *trimëror* e zuri pëposhtë *bora e madhe*, domethënë jehona e skandalit seksual të ministrit qejfli dhe as që i binte kujt më nëpërmend për të, veç po si *lëndë e parë* telefonelash, për të shoqëruar thashethemnjat brenda dhe jashtë dikasterit. Apo s'kishin kohë?! Në atë dikasteri që kthyer në refren shakaja e një specialisti shkodarin "Puna më e vështirë për ne, është të shkruajmë në informacionin e të premtes, se me çfarë e tek kemi marrë e ç'kemi bërë tërë javën".

Gjyshja e djaloi që masterxhiku i saj kapërcëu urën e Lanës, atë të këmbësorëve, të ish-ekspozita "Shqipëria sot", dhe u ngrit me të shpejtë për t'i përgatitur drekën pak si prishaqejf. Nipi s'ishte vetëm. Atë e shoqëron të një burrë aty të gjashtëdhjetave, me çfarë, që vinte pak si i shëndoshë, me një të ecur lëkundëse pirë e pa pirë, si marinar që kishte kaluar muaj të tërë nëpër detra pa dalë në

tokë. S'e merrje vesh se kush e mbante njëri-tjetrin, masterxhiku i saj, apo burri lëkundës, të cilit s'i pushonte goja dhe si një lypsar kërkonte vëmendjen e bashkëbiseduesit. S'dinte si të bënte. Të përgatiste drekën për dy vetë, apo vetëm për djalin.

- Prapë me këtë? - dëgjoi nga prapa zërin e të birit, që kishte bërë gjumin e drekës dhe ishte ngritur, për të pirë kafën e pasdites me të ëmën në këtë vakt sipas një rregulli të hershëm në familjen e tyre.

- Nuk është i mirë? Sikur e kam parë nëpër televizione duke ligjëruar...

- Ç'thua, moj mama, është këshilltari i ministrit?! Ai për veten është i mirë boll, po është tërë ditën tapë. Po ia mëson *hajrin* edhe këtij tonit. Pastaj kam dëgjuar se e përfllasin edhe si ish-bashkëpunëtor i Sigurimit...

- Si jot shoqe?

- Jo mama, njëqind herë ta kam thënë, ime shoqe ka qenë punëtore por pa uniform *atje*, që s'kam pse ta zë në gojë vendin ku ka qenë; ka marrë rrogën për atë punë, ka mbajtur familjen e ka rritur fëmijët; është ndryshe bashkëpunëtore me punëtorin; ai është si urthi, që do të fitojë diçka më tepër nga ajo që bën, nga ajo që ka. Ja, do t'ia kenë zënë kokën me derë ndonjë ditë dhe do t'i kenë thënë, pa ulu aty e firmos, në mos...Na duhesh, partia e atdheu ka nevojë për ty, po pa gjë nuk të lë...Tani thonë që e kanë bërë për atdheun, - patriotë të mëdhenj *këta* tani, - pra u kanë ardhur mendtë dhe janë në gjendje të veçojnë ç'ishte për atdheun e ç'ishte për partinë, që tani qahen se i paska shtrënguar. Po atëherë, ku i kishin mendtë, qenë motakë apo iu mungonin kjo shqisë; s'ishin në gjendje të bënin këtë dallim? Ja, shih *mikun* e djalit tonë, e shkullën nga ana e anës dhe e sollën këtu në mes të Tiranës...

- Atëherë ç'rri me të? I ka mendtë në kokë yti bir? E ka gjallë akoma babanë...

- Ç'rri thotë? Po ia do puna se.

- S'e marr vesh, e shkreta. Herë kështu e herë ashtu ti, s'di si ta marrë njeriu i shkretë. Këtu parimori, këtu lë të bir të rrrëshqarë para syve të tu. Ç'punë paskan që të kthehen dejshtëm në shtëpi?! Ç'po na dëgjojnë veshët? Yt atë ishte zyrtar i rregullit si ai ma i përpiktë, model ka qenë, dhe hëngri bukë edhe me Zogun e me Enverin, ti po ashtu, edhe vllëzërit e tu, motrat kështu. Se e patët *shkollën* në shtëpi, ndaj u bëtë të mbare, u bëtë dikushi. Po ky nga na doli kështu?

- Koha, mama, koha. Kështu është gjithë brezi i tij.

- Koha, koha në majë të gjuhës e keni si të jetë ndonjë zgapellë, që çfarë bëhet keq e për drekë në këtë vend e flakni brenda vetëm qymyr të zi!...

Masterxhiku nuk vonoi dhe u kthye i vetëm në shtëpi. Sado që nuk e vari maskën në gozhde pas dere si e këshillonin, gjyshja dhe i ati e pikasën menjëherë, se që lodhur jo pak nëpër mejhane. Ka dy ditë që është ministri jashtë shtetit dhe, ju e dini, ne i kemi si ditë pushimi, u shfaqësua masterxhiku, duke nënqeshur dhe u shtri në divan.

- Nuk të shoh mirë, - tha i ati. - Ende e mban mendjen të *ajo*?

- Ç'm'e *Ajo* mori atë që meritoi vetë. Kollaj ajo punë! Sa presin në radhë! Vetes ia bëri...

- Po ç'ke atëherë? As unë nuk të shoh mirë, mor bir?

- Psikologjisë tënde, nëna, i ka ikur koha; ta kam thënë sa herë.

Gjyshja e kapërdiu sërish shpërfilljen cinike, që e shtinte në një siklet të patreguar, si të ishte e tepër në atë shtëpi. Idhtësirës së të vërtetave të saj, që ia përplaste në sy pa teklif, nipi ia kishte gjetur ilaçin, e thumbonte, aty ku nëna s'e mbante dot, s'e përmbante veten, bëhej keq, e ironizonte.

- Atëherë çfarë ke? Kujt pret t'ia thuash, kur nuk i hapesh tëtëti? Apo atij që...

- Që më bëri drejtor të madh, do thuash? Pse hiqesh si parimor i madh, baba,

se edhe me ty e kam. Ti e di mirë, vetë më ke shtyrë a udhëhequr në çdo gjë në jetën time, apo jo? Shko këtu e shko atje, kije mirë me këtë, bëji hysmetin atij tjetrit. I harrove? Si plastelinë prej duarve tuaja jam modeluar dhe s'i del më për zot se çfarë ke bërë me mua, sikur jam tjetërsuar aq sa nuk më njeh më. Nga ai i kam të gjitha, ti e di dhe ai *miku i madh fare*, i cili flet me heshtje...Hahaha, ia ka gjetur rrefanën rrukfani. Mua më vret zoti të ankohe për të; ai më shpëtoi për pak nga spastrimi në ministri, po dhe këshilla jote, pse të ta ha hakun, që t'i tregoj ministrit të ri, se me çfarë merrej kolegu im më i vjetër, që ia kopjova me flesh gjithçka kishte në kompjuterin e tij, si provë kompromentuese...

Ai është ministri i vërtetë tek ne, ndërsa tjetri që merr paratë është si sozia e tij. Pse pyet, kur e kupton fare mirë se si funksionon te ne shteti paralel?! Një bythë mësuës fshati, që s'di askush se çfarë punon e me se merret në ministri, është më i rëndësishëm se vetë ministri ynë. A e kupton se ç'ngjet apo jo? Ç'fizionomi ka shteti ynë, ku mua më duhet të mbijetoj e të nxjerrë bukën e përditshme me këshillat e tuaja *orientuese*! Më duket se ka edhe gradën kolonel, se kështu i flasin nëpër zyra. E ku? Në dikasterin tonë! Ta shoqësh si kreshpërohet, krupën të ngjall provinciali. A e kupton se ç'ndodh apo jo? Atij ia hap në sekondë celularin *Njeriu i Shpresës së Bjerrun*, ndërsa ministri pret e pret, si paraardhësja i tij dikur, ajo e para fare që ju ndërhyt fort e më mori në punë, e cila priti plot dhjetë ditë më ditë pa sara dere, për të takuar vetëm për pesë minuta kryeministrin e vet, pra dhe *tëndin*, edhe *timin* dikur...Mos u hiq kaq parimor i madh, të paktën me mua jo, se vetë gati më urdhërove që t'i telefonojia i pari atij çamit, që se ku e more vesh, se do të bëhej zëvendësministër te ne e që ia bënë gati edhe zyrën. Ta dëgjova llafin dhe më doli bllof i paparë; ai s'u bë kurorë, - kushedi ku u prish pazari i *tyre*, - ndaj tani qeshin me mua, lajmëtarin e dështuar, urimtarin e paduruar, prandaj po të them...

- Ç'të mundon, pra? Pse nuk flet?

Një hop u vendos një heshtje bezdisëse e iluzore, që askush s'e donte dhe s'vlente për asgjë e kotsëkotë, ngaqë mendohet se është thënë gjithçka, që mund të thuhet në këtë zinxhir bisadash e hallësh të pafund, të shtëpisë dhe të rrugës, shpesh herë të nakatosua keqas mes tyre, që bëheshin në të njëjtën orë dhe thuajse nga po të njëjtët, gjyshja, babai dhe ai. Tashti sekush duhet të ndiqte regjimin e vet; gjyshja të ngrinte drekën e pangrënë; babai të zgjonte gruan e të bëheshin gati për xhiron e mbremjes si çdo ditë dhe pa asnjë mungesë deri në mbylljen e xhiros së darkës; ndërsa nipi të flinte nja dy-tre orë të mira, sa të vinte në vete, për t'u ngritur e për të parë edicionin qëndror të lajmeve, ritualin e çdo mbremje, sidomos nëse prindje ndonjë lajm me rëndësi për sektorin e tij.

- Ju o do ta nxirrni me grep, o s'iu zë shpirtit rehat. Ja, tani kam dhe hallin e atij, Guttenbergut.

- Të Guttenbergut? - shqiptuan emrin nënë e bir thuajse njëherësh dhe sekush sipas mënyrës së vet; kryqëzuan shikimet me njëri-tjetrin të çuditur, po dhe të lehtësuar më në fund, pasi djali u dorëzua, kur nuk e prisnin dhe tashmë e morën vesh se kush paskesh qenë ai që ia kish prishur qetësinë djalit të tyre dhe të tjerat ishin të sigurt se do t'i merrnin vesh më vonë e cangaca.

I ati u ngrit gjoja të qëronte një mollë, në i biri e nuhati, se ai që ngritur të hapte më mirë derën e kuzhinës, të bënte zakonin, për të dëguar gjithçka e ëma e shumëpushtetshme, që nga dhoma e gjumit bisedën në mes tyre, si vëzhgues në detyrë. Nuk kishte një shoqe të dytë për nga pathosi i saj, për të qenë e informuar, a si i pëlqente të thoshte, për të qenë në dijeni si zonjë shtëpie për gjithçka që ndodhte deri në imtësi, si të mbulonte të gjitha *shërbimet*...

- Gjerman është ky? Kështu më tingëllon mua... - tha gjyshja.

- Po, po të Guttenbergut, po jo atij që shpiku shtypshkronjën, është tjetër Guttenberg ky...Nuk mundi ta linte që t'i humbiste rasti pa e thumbuar gjyshen.

(Vijon në numrin tjetër)

P

PUBLICISTIKA

NGA KRENAR ZEJNO

Columbus Day. Dhe një rast për t'u shpërngulur sot në Tjetrin kontinent, ku një 12 tetor, shkuar afro gjashtë shekuj, pat përmbyllur zhvendosjen e madhe historike Kristofor Kolombi, simbol i shpirtit eksplorues, determinimit, zbulimit, aventurës dhe sfidave të lundrimit. (Sapo e përsëriti formulën e radhës në përvjetorin e radhës, edhe vetë presidenti i radhës i Shteteve të Bashkuara).

Kjo është veç njëra anë e pamjes së shtatoreve të tij, kudo ku gjendet, në Genova, Neë York apo në Columbus, kryeqytet i Ohaios, dikur breg i mbërritjes në një Mundus novus. Ana tjetër, i shpërfaqet një tjetër perceptim: atij prej kolonizuesi skllavërues, grabitqari përdhunues, torturuesi shfarosës, gjer ushtrues genocidi. Për pasojë, në çdo tetor, sillen anerrtotull shtatorës edhe ata që, si nën të drejtën e tyre, duan ta dhunojnë, ta shkulin e shfarosin atë nga faqja e dheut. Dhe, atypëraty, asgjësimin e ditës festë kombëtare dhe zëvendësimin me një Genocide Day.

Ndërkaq, edhe në Romën imperiale turma po i vjen vërdallë piacës rrethore në Eur, ish-kryeqendra e Fashios, gati për t'ia shkullur mermerit ku është gëdhendur emfazën e një Italie "paese dei santi, navigatori e poeti", përsëritur e sokëllitur prej Duces në një tetor nga të erës së tij, kur e kishte ende edhe erën në krah.

Deri sa një shtatore e re - me gjasë nën emër kolektiv dhe në emër të gjestit të mbrojtjes së lirive e të drejtave humane -, do të përkujojë aktin e rrëzimit të shtatores së Kolombit dhe bëmatve të tij: si të liga e të papërshtatshme me kohën e sotme...

Gjersa një kohë tjetër, duke risjellë ndërmend nën një tjetër perceptim se nocioni i skllavërisë dhe, për rrjedhojë, koncepti i zbulimit dhe kolonive kish të tjera shtysa, norma e ligje, do ta gjejë të papërshtatshëm vendimin e rrëzimit të bustit, e kështu do ta rivendosë atë aty ku ishte para se të shkulej prej aty dhe të zhvendosej me dhunë. E kur almanakët do të përmbajnë, kësisoj, edhe një shtojcë gjithë e më interesante për t'u rikujtuar si pjesë e historisë: datat përkujtimore të lindjes dhe vdekjes së shtatoreve, e në rastet e përshtatshme, edhe ato të ringjalljes dhe rimishërimit të tyre.

Mëpastaj, mbase do të vijë edhe kohë të tilla kur statujat e përkundërta do të qëndrojnë më këmbë përkundruall njëra-tjetrës e do të kundrojnë tjetra-njërin duke buzëqeshur, nëmos dhe duke u gajasur, prej faktit se: të shkullësh një frymëzues të gjeneratave të cilat aq natyrisht i ngjajnë në shumëçka, përshtirë edhe lehtësinë e shfarosjes, vetë frymëzuesit që po shkulin, nuk është aq e lehtë të rezistosh pa u shkullur gazit para argumentit.

Ishte era kur ndërmarrje të tilla, asokohe u bënë të mundura saje lëvizjeve edhe të përkundërta, njëherit shkullmuese heretike, dhe po aty falë bekimit dhe përkrahjes së klerit e në këmbim të përhapjes së Krishërimit kudo ku shihej e shtrihëj një botë. (Mirë që bota na genka e rrumbullaktë, po të paktën ta shtyjë të rrotullohet e kthehet nga ana jonë, ana e duhur njëherë e përgjithmonë!)

Tani, duke i ardhur vërdallë përshkrim-it, si Magelani, le të kthehemi prapë të Kolombi: në zanafillë, nisja për të zbuluar një

Ndoshta pasuria e vetme, pastërtisht legjitime, që ka lënë Kolombi mbetet vendlindja e tij, Gjenova. E tij po aq sa e Mazinit dhe e shën Gjergjit (me të cilin shqiptarët i lidh më shumë se thjesht një emër). Është për hir të këtij qyteti dhe ndikimit të frymës së tij në të, që Italia vijon të thirret "paese dei santi, navigatori e poeti". Qytetit që vijon të pjellë Montale, de Andre dhe poetë të muzikës së lundrimit, si dhe të bujtë si banorë të saj rrëfyesit e mëdhenj të qytetit, nga Petrarka te Dickens, Shelly, Bajron, deri te Virginia Woolf e me radhë.

# Veza e plasur e Kolombit

udhë detare për në brigjet indiane; gjëja më e çmuar në pajimet e bordit: busulla, një nga shpikjet rishtarë më ndikuese të krejt historisë. (por, në fakt, si e përse akrepi magnetik shigjeton gjithmonë nga veriu!; dhe ky reagim gati "instiktiv" e kjo qëndresë parimore veç kah i njëjti drejtim!); pastaj, një gabim pothuaj trashanik i përlogaritjes së perimetrit të tokës, ndonëse ende mezi pranohej që ajo është e rrumbullt (po, vërtet, çfarë i mban vallë vaporet e mëdhenj që të mos i bien!); për pasojë, mbërritja tjetërkund, por nën bindjen e plotë se ekspedita gjendej në

anët e Indisë dhe jo në anën e historisë. Bindje nën të cilën, Kolombi i rikthyer në Spanjë, siç dihet vdes në mizerje, pa e mësuar të vërtetën e zbulimit të tij. As atë të mëkatit të vet.

Ndonëse, nga një këndvështrim tjetër, duke e parë edhe më ngushtë e në terren dyluftimi real, bën vaki që kur gjakrat ndizen flakë në kacafytje trup me trup, në ndonjë rrip toke ku nga bregu i nisjes matanë të ndajnë qindra ditë edhe milje dhe e di me lëkurë që s'je amfib, kuptimi i fjalës "gjakatar", është aq i papeshë si të thoje, për shembull, banor i pëllgut të së kuqes. Kup-



tim i cili, i flakur nëpër histori, ndez e ushqen zjarrin e së keqe edhe pas shekujsh. Ose në rastin më të mirë, enjtet ashtu si pa të keq, siç një insekt pas vaktit të pickimit. Më tej, historia gjen gjithmonë një kohë ca më të paqme dhe mënon të shkarkojë barën e mëkateve dhe mëkathit të simbolet e veta mishëruese.

(Sot e gjithë ditën, si qysh në krye të herës, kanuni themeltar i lundrimit e quan krim mosdhënien e ndihmës në det të hapur çdo nevojtar, pa kusht e pa kufizim. E po të që fjala për ndjeshmëri ndaj tjetrit, ja ku na thërret për empati njerëzore emergjenca aktuale, sesa historia e shkuar me shekuj. Mirëpo, histori është gjithë çka nuk ka të bëjë me të tashmen.)

Ndoshta pasuria e vetme, pastërtisht legjitime, që ka lënë Kolombi, mbetet vendlindja e tij, Gjenova. E tij po aq sa e Mazinit dhe e shën Gjergjit (me të cilin shqiptarët i lidh më shumë se thjesht një emër). Është për hir të këtij qyteti dhe ndikimit të frymës së tij në të, që Italia vijon të thirret "paese dei santi, navigatori e poeti". Qytetit që vijon të pjellë Montale, de Andre dhe poetë të muzikës së lundrimit, si dhe të bujtë si banorë të saj rrëfyesit e mëdhenj të qytetit, nga Petrarka te Dickens, Shelly, Bajron, deri te Virginia Woolf e me radhë.

Nga veprat më të larta të ndikimit prej tij mbetën përgjithmonë: kapiten Ahabi, Melvili, Balena e bardhë, Konradi, fantazma elokumente e Kurcit, Tweini, kapiteni Hateras, nën ndikimin e të cilëve gjithashu, u blatua masivisht ai shpirt veprimtar, iniciator, udhërrëfyes dhe idealist i vetë Amerikës.

Nga gjërat më të vyera që Kolombi i solli botës kësoane që fara e misrit, kokrra më e shëndetshme e së cilës në Ballkan, do të shërbente për të ushqyer "Legjendën e misrit" dhe thyer urinë e poetit në kohën e hipokrizisë së vulgut: mos e shkel, he t'shitofte zana!

Nga bëmat më frytdhënëse në rang botëror, mbetet sidoqoftë ajo puna e vezës... frymëzuese edhe e shpirtit praktik, konkretist dhe pragmatist të kontinentit të ri.

Amerika mban faktikisht për kumbar një Vespuç, gjithaq italian, që na zbuloi se zbuluesi i saj faktik nuk e kuptoi që realisht pat zbuluar një Mundus novus dhe jo Indinë për në të cilën që nisur në fakt. Për të tjerat, as satira e Suifit të "Guliverit" dhe "Betejës së librave" nuk pati ndonjë përgjigje shteruese veç marazit: Kushedi c'do kish zbuluar Kolombi po të mos i kish prerë udhën Amerika!

E për ta njohur më mirë historinë e vërtetë, i bie më mirë mos ta marrësh vërtet seriozisht historinë e njohur. Nëmospo, veç pasi të kesh kaluar kalvarin e jetës së vërtetë (ose, që të mos i biesh prapë si Magelani, së paku atë përmes leximeve), që të bën të kuptosh se historia e vërtetë është një histori e gabimit, madje e keqkuptimit, motor i historisë, thënë sipas emërtesës së Xhojsit.

Sido me qenë, veza pulën apo pula vezën, me ose pa statuja Kolombi apo pëllumbash paqeje, me siguri nuk do mund të rrezohet dot veza e tij: shtatore e sfidës se si një gjë në formë elipsoidale mund të qëndrojnë më këmbë pa u rrëzuar! Të paktën për sa kohë nga humaniteti do të ndjehet ende nevoja për metaforë dhe trajta eliptike përshkrimi historie që rreken t'i përmbushin të dy anët e rezultatit, të dy palët në bast: qoftë, në këmbë ama e thyer - qoftë, e thyer ama më këmbë!

\*K. Zejno, Lago di Garda, 12 tetor 2018



## P

POEZI

NGA QAZIM D. SHEHU

Krisma fjalësh mbusha me ajër  
Jehonën larg për t'u cuar,  
Në vargje stinësh të pamatshme,  
Që përtonin duke u ndërruar.

Vetëm ajri për të më kish mbetur  
Thelbi u rrinte në brendësi,  
Në tokë të mendimit gjaketur,  
Ndonjëra fshehtas kishte mbi...

Dhe kur gjethet ia pashë,  
Biskun e filizit të harlisur,  
U ktheva nga largësitë dhe rashë  
Nën hijen e fjalës së ditsur....

## URREJTJA

S'kemi kohë për dashuri,  
Urrejtja i vuri flakën tokës,  
Më duket vetja se po rri  
Duke prituri Varkën e Noes.

Pres përmbytjen pa dëshpërim,  
Përderisa dashuri s'kam më,  
Urrejtja për mua s'është qëllim,  
Po edhe s'mund të rri pa të...  
KOHË E GJATË  
Të desha, s'të desha  
Por s'mundem më,  
Dashuria mbaron si jeta,  
Kujtime tmerruese lë.

Humbi pasioni demoniak,  
Luleshkërmoqur në gërmadhe,  
Dhe s'kuptoj pse gjen shkak,  
Zemra të rrahë si e marrë?  
ERA  
Një mijë thikat e erës  
I mpreh xhelati,  
M'u fanepse pas derës  
Flakur prej natës.  
Derën hapa, s'të pashë,  
Sërish ike siç di ti,  
Mos të pëlqeu era me xhelatë  
Nga që s'kam mëshirë, as dashuri?

## NGA ZEMRA

Nga zemra u ndez intimiteti  
Hija e sorkadhes nga era,  
Eja, merre zemrën time,  
Ca buzëqesha, e të tjera.  
S'munda të bëj dhuratë,

Para, mall e gjë,  
Vetëm zemrën si pishtar,  
E shkul e ta lë...

## ZOGJTË

Vera s'do të ikë, pasqyrat turbullon,  
Fundshtatori pisket si fillim vere,  
Përmes këngës që flirton,  
Erdhën zogjtë kësaj here.

Ju ta dinit të dashurit zogj,  
Si malli më pikë për ju,  
Në qiellin që lëkurën poq,  
Vështrimi im u bë flu...  
Gëzimin që sollët tani,  
Me këngën e fliritit blu,  
Ia vesh lëkurës së qiellit për freski,  
Në ajër një çerdhe bëj për ju  
Dhe ku ndodhet s'e di.....

## MOS JE TI?...

Nganjëherë më bëhet se të kam parë në një  
ëndërr,  
C'ëndërr qe, nuk e mbaj mend,  
Veç di një ëndërr që s'është zhgëndërr,  
Mos vallë je ti ajo, përnjimend?!

## EDHE...

Fantazma rri në ajër,

S'guxon të ulet mbi tokë,  
Krimet, helmi dhe vrasjet,  
Ngrihen përjetë si flokë.

Një çast, shkon e tmerruar,  
S'mund të pëshpërisë një fjalë,  
Ndoshta duke u zvogëluar,  
Edhe mund të na falë...

## BESNIKËRI

Ajo që e desha, si Penelopa  
Nuk shpiku një pëllhurë,  
Thuri vetëm dokrra  
Për të më bërë urë.  
Nga që urë s'u bëra  
U vërvit hapësirave si toka,  
Dhe ajo është e tëra,  
E qajtur gabimisht Penelopa...

## MBULESË

Mbulohemi me gabimet tona,  
rroba të lehta,  
marrëzitet e vona vodhën  
çka të arsyeshme kishte jeta...  
Shfrimin ulërimë tek horrat,  
Ata rroben na vjedhin,  
U shohim atyre të korrat,  
Në sharje ua hedhim...

## E

EX LIBRIS

NGA BAJRAM SEFAJ

Mbi Baruk Spinozën, filozofin e filozofisë së sigurtë e pagëzuar, shpesh herë deri në këtë çast, shumë mendimtarë e shkrimtarë kompetentë, nuk kam qare pos, pa fije hezitimi, të pajtohem me ta! Është folur e shkruar shumë për të. Libra të trashë, madje edhe romane voluminoze. Ndër më të shquarit është "Problemi Spinoza" i shkrimtarit me emrin, Yalom Irwin, që, për fat të mirë, kohë më parë, është përkthyer shqip dhe është në duart e lexuesit shqiptar. (Një roman shkruar me pasion dhe mirë i dokumentuar, që tërheq paralele të jetës së Spinozës dhe ideologut nazi Rosenberg. Filozofia e Spinozës nuk ishte tjetër pos një gërvishitje).

Megjithatë, publiku i gjerë lexues shqiptar, sikur nuk e ka idenë se kush, në fakt, ishte Spinoza. Vë bast (me kënd të dashur, e me çka të duash) se pakkush prej nesh, me përjashtim të ca vetave që filozofinë e kanë profesion, ose që e kanë pasë lekturë shkollore, e dinë emrin e Spinozës. Mbiemrin po, emrin Baruk, jo! Garant!

E kush është Baruk Spinoza, pra? Baruk Spinoza, është hebre me prejardhje spanjole. Prindërit i shpërngulën në Porugalinë fqinje. Baruku lind në Amsterdam të Holandës, në vitin 1632, ku jetoi dhe krijoi deri në vdekjen e tij të hershme. Dyzet e pesë vjeç, më 20 shkurt 1677. I njohur vetëm si Spinoza, në Holandë krijoi shumë vepra kapitale filozofike, prej të cilave disa i la të nisura e të papërfunduara nga se jetën e kishte të shkurtër. Si kryevepër e tij çmohet titulli "Etika" e shumë të tjera të përmbledhuara dhe të botuara (Euvres complètes), në Bibliotekën e njohur franceze "Pléiade". Ndonëse jetëshkurtër, Spinoza ishte një nga filozofët më të spikatur dhe më ndikim të kohës së tij dhe si i tillë vazhdon të jetë edhe sot e gjithë ditën.

Ata lexues të zellshëm që duan e, që kanë ambicie të shëndosha, të mësojnë më tepër dhe, më për se afërmi e më thellë, ta

Libri i sociologut dhe shkrimtarit francez, Frédéric Lenoir, "Mrekullia Spinoza" lexohet me kënaqësi e admirim. E botoi shtëpia botuese "Fayard" e Parisit, në dhjetor të vitit 2017...

## Spinoza, filozof mbi filozofë

njohin jetën dhe veprën madhore të këtij filozofi të shquar të shekullit XVII, le të udhërojnë e le të lexojnë librin e shkëlqyer të sociologut (filozofit) dhe shkrimtarit francez Frédéric Lenoir "Le miracle Spinoza". Nëse jo sot, atëherë, pra, kur ky libër i spikatur, të përkthehet e të botohet në gjuhën tonë të bukur. Votoj (ngre zërin!) që kjo të ndodh sa më parë e mundur. Nga se fjala është mbi një veprë madhore që lexohet me endje (them unë), "... gati si një triler...Një lekturë që të jep forcë dhe energji të pa besueshme", sikurse e cilëson, në një letërkëmbim me autorin Lenoir, mikun dhe njohësin i veprës së tij, Robert Misrahi.

Autori Frédéric Lenoir, materies (brumit) të veprës se vet në shqyrtim, i prinë me një sqarim dinjtoz që, në një farë mënyre, mund të lexohet edhe si nëntitull sqarues i 230 faqeve të librit të tij: "Një filozofi për të kthjelluar (ndriçuar) jetën tonë", e ndanë në dy pjesë. Secila më goditur se tjetra.

Pjesa e parë hapet me një citat të Spinozës "Ne pas se moquer, ne pas se lamenter, ne pas détester, mais comprendre" (Mos të shpotisim, mos të vajtojmë (lamentojmë), mos të urrejtmë, por të kuptojmë – kështu dësi, tjerë në shqip!) dhe, natyrisht me parathënie e autorit që, në fakt, është një shprehje për imtuesë pakapërcyeshme, do të thosha, për ta kuptuar sa më mirë dhe, ashtu si duhet, këtë libër, nga se "Spinoza është një nga ata autorë që mund të ndryshojnë një jetë!" në përfolin e secilin, ngase secili titull flet vetë dhe shpreh përmbajtjen e temës së shtjelluar.

Në mbarim të kapitullit me numër shtatë (7), instinktivisht kam shënuar: Spinoza dhe Ibrahim Rugova! Pse e si nuk e di. Mbase nga shkaku se ky kapitull përfundon me konstatimin se Spinoza, tërë shekuj para Gandit, e kishte kuptuar se revolucion i vërtetë është së brendshmi dhe se duke u transformua në vetëvë, ai ndryshon botën. (interpretim i lirë, kërkoj ndjesë në rast lajthitjeje!).

Ndërkaq në pesën dytë të këtij libri

kemi këtë pasqyrë: Mjeshtëri i urtisë, është si një kryetitull në gjirin e të cilit vijin shtatë njësi tjera: Etika, një udhërrëfyes (guid. itinerar) rreth kënaqësisë dhe të përkryerës, Zoti i Spinozës, Fuqizim, përsosmëri, gëzim, Kuptimi i afekteve që na udhëheqin, Kultivimi i dëshirës, Përtej së mirës e së keqes dhe Liri, përjetësi, dashuri. (Ndërrhyrje imponuese: nuk e kam të cartë a e vërejtët, lexues të nderuar, se këto dy parti të librit autori Frédéric i pjesëton për shtatë. Dy herë shtatë baras me katërmëdhjetë. Kjo do të thotë dikca, padyshim!).

Pastaj, logjikisht, vjen Konkuzioni, mbi reflektimin e Madhësisë dhe limitëve të sionizmit, teksti i parathënies se Robert Misrahi dhe një letërkëmbim miqësor i Lenoir-it me të.

Të gjithë katërmëdhjetë kapitujt dhe pjesët e tjera ndihmesë të këtij libri lumë, "shpëtojnë" pa përpjekje zbrëthimesh, shpjegimesh e komentesh naive e boshe. Ky "lëshim"

etik e profesional, bëhet me qellim të vetëm finisik, mos të lëndohet (keqtrajtohet), një veprë e madhe kushtuar Spinozës, këtij filozofi suprem.


"Shpalimi" i titujve dhe renditja e tyre, një për një, në këtë shkrim modest, sikur më së miri dëshmojnë dhe pasqyrojnë përmbajtjen e këtij libri të rrallë e të çmuar, jo vetëm për qarqe të ngushta filozofesh e shkencëtarësh, por i mirëseardhur për një opinion të gjerë lexuesish.

Derisa mbi Spinozën dihet e s'dihet aq shumë, kurrë aq sa duhet, po kush (na) ishte (është) ky zotëri, Frédéric Lenoir?

Për lexuesin tonë mbase është emër krejtësisht i panjohur. Për opinionin e gjerë publik (lexues) francez, ai është shumë i dashur dhe i respektuar. Autor i sa e sa veprave, me tirazhe të larta, letrare e filozofike, posedo. Nga të cilat ndaj, nënvizoj e veçoj, atë me titull "Mère Teresa" që shkroi në bashkautorësi me Estelle Saint-Martin, dhe e botoi "Plon" i Parisit, më 1993. Ai u bë edhe më i njohur, edhe më i dashur, pas botimit të librit "Le miracle Spinoza" (Fayard, dhjetor 2017). Vetëm brenda një muaji (dhjetor) Mrekullia... mrekullisht u shit në 200 mijë ekzemplare. Kjo veprë Lenoir-it, sociolog dhe eseist, përnjëherësh u bë bestseller dhe Spinoza i tij superstar.

Monsieur F. Lenoir, shkruan, pagtë, shkruan lehtë dhe lexohet aq lehtë. Nuk filozofon. Shkrua thjeshtë e qartë sa që sikur shlyen bregëni e barrierës së mosnjohjes, në masë të duhur, të gjuhës së veshitë e, herë-herë, të koklavitur edhe për vetë ata që, gjuhën e Molierit, gjuhë amtare e kanë.

Revolucionar politikash dhe religjionesh, një si krye kapitull ky, në cilin pastaj, njeri pas tjetrit, hyjnë tituj vijues të kësaj pjesë (të parë) të këtij libri: Kthim filozofik, Njeri i lënduar, Një mendimtar i lirë, Një lexim i lirë i Biblës, Spinoza dhe Krishti, Një tradhti e judaizmit dhe Mendimtari i Dritave. I rendis të gjithë shtatë titujt e të po aq kapitujve të pjesës së parë, pa e marrë mundin që të ndalem



P

ROMAN

*Banorët e trevës, që janë aty mes shekujsh, ndoshta nga ai brumi i vërtetë i Epirit, për të cilin zihen historianët e dy vendeve tona tregojnë se në shumë raste i kalojnë edhe zakonet e zakonshme të grekëve dhe shqiptarëve. Janë konservatorë të mirë, por aspak të tepruar, ashtu si e gëzojnë jetën me të gjitha mushkëritë. Por, diku u vigjilon një alert pabesie, ai që njohin më së shumti njerëzit sot nga historia e tyre e jashtëzakonshme...*

NGA BEN ANDONI

**K**ur vite më parë u botua në Tiranë "Bretkosa" e Mo Yan, shu mika besonin se kjo ishte një tepri, thjesht për të prezantuar më shumë një autor nobelist në tregun e vendit. Por, e vërteta rezultoi të ishte krejt ndryshe. Përmes një komune të harruar, autori, përcillte nga problemet më të mëdha të Kinës, që i qëndron mbi shpatulla prej dekadash të tëra. E më shumë akoma, njerëzit patën fatin të shijonin me vetëm një botim historinë e Kinës përmes letërsisë. Kjo është mrekullia e profesionalitetit...por edhe e vetë historisë.

Në një areal krejt tjetër, një autor shqiptar, me asfara përvojën, renomën, mbështetjen dhe njohjet e autorit kinez arrin të bëjë diçka të tillë për një komunitet, i cili sot ende nuk gjen dot fillin e çmpleksur keqazi të historisë së vet fatkeqe. Tom Kuka, autor i romanit të dytë personal, "Gurët e vetmisë" bën një "provokim" të mrekullueshëm duke na treguar se çamët, mu ata, që njerëzit i identifikojnë sot si një komunitet i shpërngulur dhe pa histori mirëfilli, myslimanë të devotshëm, në rrënjët e tyre ishin dhe mbeten një nga komunitetet më interesante të etnisë shqiptare.

Autori përdor në narracionin kryesor vetën e tretë dhe kjo është e kuptueshme sepse i duhet të menaxhojë një galeri të tërë personazhesh, të tre moshave, kryesisht



## HISTORIA E ÇAMËRISË PËRMES LETËRSISË



çamë por edhe të huaj me të cilët tregon historinë e panjohur të Çamërisë dhe shtjellat e saj, në lëmë antropologjikë dhe socialë.

Banorët e kësaj treve, që janë aty mes shekujsh, ndoshta nga ai brumi i vërtetë i Epirit, për të cilin zihen historianët e dy vendeve, tregojnë se në shumë raste i kalojnë zakonet greke dhe shqiptare. Janë konservatorë të mirë por aspak të tepruar, ashtu si e gëzojnë jetën me të gjithë mushkëritë. Diku u vigjilon një alert pabesie, por këtë e hedhin poshtë sepse me grekët janë bashkë.

Autori ynë ka zgjedhur formën e një kompozicioni të ndërlikuar dhe kjo e tregon jo thjesht të kulturuar sa i përket njohjes së strukturës letrare, por edhe shumë kërkuës ndaj vetes. Në fakt, kjo lloj strukture, që po ta kuptosh e bën pak të lehtë dhe me frymë shtjellën e romanit, na njeh me sfidën e autorit. Autorit i duhen shumë personazhe për ta parë realitetin çam në gjenëzë, apo të themi në atë që njerëzit sot e harrojnë prej pogromit ndaj tyre dhe që e lidhin vetëm me kalvarin e tyre.

Stili është i ngjeshur dhe autorit i pëlqen shumë të befasojë, duke shkrirë të gjithë kategoritë estetike. Të bukurën e të

shëmtuarën...Për ta ndihur rrëfimin e tij, ai përdor natyrshëm gjuhën e vjetër çame. Por, këtu sfida e tij mbetet pak sepse leksiku deridiku i kësaj treve nuk i shkon me sintaksën e vërtetë të toskëve çamë. Gjithsesi, kjo tejkalohet lehtë, sepse përdorimi i këtij leksiku thjesht është ndihmë për lexuesin dhe duket se nuk është aq detyrë e fiksuar e autorit.

E mrekullueshme është dinamika e personazheve të tij, që nga fillimi dhe deri në fund dhe mënyra sesi interferojnë të njëritjetri, duke e bërë të gjithë këtë ndodhi të shkuar të duket se është mu aty fare natyrshëm dhe mund ta prekë gjithkush. Sipas një zakoni, që tashmë po i kthehet në detyrë, në rolin e atyre piktorëve të dikurshëm, që diku fushin dhe veten e tyre, autori e përfshin sërish Tom Kukën, si personazh real. Madje, prej këtij personazh, lexuesi fillon e bën lidhje instiktive me romanin e parë, ku sërish Toma shfaqet natyrshëm.

Aman, në këtë oaz qetësie, humori dhe mbijetese të bukur, si në librat e vjetër fantazma e një banori përcillet të njerëzit e tij. Diçka po vjen, por askush nuk e parashikon dot katastrofën e madhe dhe të frikshme, pasi askush nuk e beson që natyra

njerëzore të ketë kapriço të tilla. Nga ajo që dëgjojnë, por që nuk e besojnë, këtij idili të bukur të natyrës njerëzore, po i vjen një fund...Veçse banorët aq të dhënë pas marrjes së lëngut të jetës nuk duan ta besojnë sepse jeta e përditshme është më e bukur se çdo fantazi.

"Fëmijët pasi mbushnin barkun me mishra dhe mëlçi, rendnin gjithandej në lëndinën e larë nga drita e hënës. Servet Kamati, Agathia, Abedini, Hëna, nanë Zisja, Dajkoja, Resoja, Nekia, çilimnjtë, por edhe Muharrem Mërria me të bijtë bënë këmbë në këtë festë, ku askush nuk pyeste më për mish e raki. Taqo

Mullisi solli tavat e mëdha me klumështuar që të ëmbëltonin gojën gostarët, tekta vesa e natës lagu gjetet e ullinjve.

Dikur, kur agu po zinte natën, dhëndri kërcëu mbi automobil dhe nisi t'i binte kazasë me fëmijët përsipër që qenë ngjitur cit më cit. Pastaj i mori me rradhë burrat dhe i çonte lart e poshtë. Patën guximin dhe hipën bashkë me të bijtë dhe dy gra, Shanishaja e Grikohorëve dhe Havaja e Hadove. Muharrem Mërria nuk dëgjoji që nuk dëgjoji të ngjitej".

Në të gjithë librin, përshkrimet lirike por edhe të situatave e bëjnë autorin jo thjesht ta administrojë lëndën, por edhe të tregojë se tashmë mund të konsiderohet si një zëjtari i mirë i letërsisë. Dhe, këtë e shikon jo thjesht nga gjuha por mbi të gjitha sensi i masës.

Pikërisht kjo e fundit e bën që të mbledhë të gjithë atë tis, që kanë përcjellë personazhet dhe në pak faqe të fundit të na sjellë masakrën, që është sinteza më e dhimbshme e historisë së Çamërisë. Kjo e fundit tashmë nuk ka shifra, por ka emra, orendi dhe kob.

E gjithë ajo prejhe e bukur merr fund sepse tashmë për çamët fillon tmerrin i jetës së gjallë, ku ata enden si të vdekur. Pleqë bëjnë paktin e madh të vdesin si nënë Zisja. Të rinjtë vazhdojnë më tej...por me kokën pas, duke mundur të shpëtojnë kë të mundin E gjithësesi... shpresa vazhdon edhe pas thirrjes kobzeze: *I paskan prerë e përvëlur Takëjtë, Muharremëjtë, idrizlerët, Tahirenjtë, Dinejtë, Shabanejtë. A e ndien Avdul? Ky është edhe fundi, ai që e trand lexuesin e thjeshtë dhe e heq nga ai lexim i këndshëm për ta lënë të mendojë...për historinë.*

Titulli: Gurët e vetmisë

Autori: Tom Kuka

Botues: PEGI

Gjinia: Roman

Çmimi: 800 Leka

Faqe: 210





Opinion *i* Ditës

# Merkel dhe Lëv drejt “skualifikimit”?

Nga Jorgji Kote

(vijon nga faqja 1)

... gjendje alarmi “SOS”! Kjo po ndodh këto ditë me Kancelaren gjermane, Angela Merkel dhe kryetëknikun e futbollit gjerman, Joachim ose Jogi Lëv (Joachim Löw), siç njihet gjerësisht; që kanë aq shumë pika takimi në fatin e djeshëm, në pafatësinë e sotme dhe në misterin e të nesërme. Të dy kanë 13 vjet që drejtojnë ekipin qeveritar dhe të futbollit, të dy fitues të mëdhenj trofesh; Merkel katër herë Kancelare, Lëv kampion bote dhe me tri trofe evropiane/gjermane, por edhe rreziqe e humbje të mëdha, sidomos këtë vit. Specifikë tjetër unikale është se si suksesin dhe dëshitim të tyre e ka pasur në dorë si askund tjetër në botë i njëjti rajon/metropol - Bavaria; politikisht drejtuesit e CSU-së “motër” për Merkel dhe ekipi i Bajernit me teknikët e futbollit për Lëv.

Mirëpo tani, si Merkel dhe Lëv kanë përballë dy sfidat më serioze dhe vendimtare për jetën e tyre politike dhe sportive: Merkel këtë të diel me CDU-në e saj kanë “ndeshjen” e madhe zgjedhore në Hessen, shtetin e vogël me 6 milionë banorë; konfirmimi i kryeministrit të saj aktual kërcënohet nga të Gjellbërit dhe ekstremistët e AfD-së, që shënojnë rritje të ndjeshme në sondazhet e fundit përballë rënies së CDU-së. Humbja e kësaj të fundit pas disa krizash politike të muajve të fundit do ta vinte seriozisht në dyshim rikandidimin e Merkel si kryetare e CDU-së në “ndeshjen” tjetër politike, Kongresin e muajit dhjetor e për pasojë edhe të ardhmen e saj si kancelare. Por, edhe në rast të fitores së saj në Hessen, telashet nuk sosin për Merkel, sepse mbijetesa e saj politike do të përcaktohet dhe nga rezultati i aleatit të saj SPD-së në Hessen, ku sipas sondazheve të fundit, SPD pritet të pësojë humbje të rëndë, duke u renditur e treta pas të Gjellbëve ose dhe më keq. Pas një humbjeje të tillë të mundshme, SPD-ja e ka bërë të qartë se do të largohet nga koalicioni i tanishëm federal, për të shmangur tatëpjetën drejt greminës politike dhe për të paguar me koston e madhe politike të këtij koalicioni dhe sidomos grindjeve të brendshme ndërmjet CDU/CSU. Nr.2 i CDU-së, zonja Karrenbauer e bëri të qartë dy ditë më parë se largimi i SPD-së nga koalicioni do ta çonte vendin pashmangërisht në zgjedhje të reja të përkohshme. Mirëpo ky do të ishte edhe fundi politik i Kancelares Merkel, madje kundërshtarët dhe zëvendësuesit e saj kanë dalë sheshit qysh tani.

Në këtë pozitë dëshpëruese të



dyfishtë ndodhet dhe trajneri i Kombëtares, Lëv, në prag të ndeshjes vendimtare më 19 nëntor ndaj Holandës së vogël, por me historitë të madhe futbollit, që e posh-tëroi gati një muaj më parë 3-0. Ka vetëm një pikë në renditje, vetëm fitorja ndaj “tulipanëve” e shoqëruar edhe me humbjen e tyre përballë francezëve mund ta shpëtonte largimin e Lëv nga pankina e Kombëtares gjermane dhe këtë të fundit nga rënia në Kategorinë e Dytë të Ligës së Kampioneve.

Dikush mund të ketë rezervë lidhur me këtë paralelizëm dhe të thotë se futbollit është kthyer kudo në “magji” me kulmet e njohura në Brazil, Argentinë, Itali, Spanjë, në Francë, kampione e sivjetme. Por, edhe në vende të vogla si Belgjika, ku vitet e fundit sukseset e “Dijave të Kuq” e kanë bashkuar atë si rrallëkush me sloganin “tous ensemble”.

Gjithsesi, si komb i madh dhe i njohur futbollit, ky i fundit i ka dhënë tonin Gjermanisë si askund

tjetër, madje ka kushtëzuar klimën, mjedisin dhe atmosferën e jetës publike dhe politike gjermane.

Sepse, siç u përmend më sipër, vështirë për të mos thënë, e pamundur, të ketë vend tjetër të madh në botë, ku i njëjti rajon, siç është Bavaria të përcaktojë me superyjet e saj, si ekipin kombëtar të futbollit, ashtu edhe koalicionin qeveritar; më konkretisht me ekipin elitat të Bajernit dhe CSU-në “motër” të Bavarisë. Dhe këtu nuk bëhet fjalë për koincidenca apo raste të veçanta, por për rregullsi apo “bashkëjetesë” në harmoni të plotë ndërmjet futbollit dhe politikës gjermane në shtatë dekadat e fundit.

Kështu, kur në vitin 1954 Kampionati Botëror zhvillohej në Zvicër; Gjermania që po rimëkëmbëj nga shkatërrimet e luftës, pasi kishte humbur nderin dhe prestigjin në botë. Ndërkohë, falë Planit Marshall, punës vetëmohuese të popullit gjerman dhe politikëve

të tij legjendarë, Kancelarit Adenauer dhe ministrit të Ekonomisë, Ludwig Erhard po krijohet mrekullia ekonomike dhe sociale. Gjithsesi, ishte fitorja e papritur e Botërorit në Zvicër duke përmbytur rezultatin nga 0-2 në 3-2 ndaj “magjarëve të plotfuqishëm”, që i parapriu asaj me atë që njihet si “mrekullia e Bernës”.

Plot 20 vite më vonë, Botërori zhvillohej në Gjermaninë që ende nuk e kishte marrë veten nga Masakra në Olimpiadën e Munitut më 5 Shtator 1972, ku banditët të “Shtatorit të Zi” palestinez morën peng dhe ekezkutuan 11 atletë dhe trajnerë të ekipit izraelit. Por vendi ato ditë ishte tronditur thellë edhe nga dorëheqja e papritur e Kancelarit legjendar nobelist të “Ostpolitikës”, Willy Brandt, pasi njëri prej ndërmbësve të vet ishte spioni i STASIT gjermano-lindor.

Ndërkohë që në futboll po shkëlqenin holandezët me Cruyffin fluturues dhe vje të tjerë, një “kërcënim” serioz për ekipet e mëdha dhe mikpritësin. Gjithsesi, magjia e futbollit gjerman e bëri sërish të veten, duke ua rrëmbyer trofeun “tulipanëve” me golin e artë të të famshmit Gerd Myler.

Viti 1990 erdhi plot trazime dhe sfida politike për të dy Gjermanitë dhe Evropën. Sapo ishte shembur Muri famëkeq i Berlinit dhe vijonin me intensitet demarshet diplomatike për ribashkimin gjerman mes një atmosfere të shoqëruar me entuziazëm, por edhe me drojë, frikë, dyshime, hezitime nga fuqitë e mëdha dhe opinionin publik. Në ato momente historike të gjithë i kishin

hedhur sytë në Itali, te djemtë e Kombëtares gjermane, Klinsmani, Fellers, Mateus etj., të cilët triumfuan ndaj Argentinës së Maradonës legjendar. Kështu, trofeu i tretë botëror ndriçoi dhe ndezi atmosferën si një preludi i bukur i ribashkimit më 3 tetor të atij viti.

Dhe kështu vijoi historia gjermane e binomit futboll-politikë, që arriti sërish kulmin me titullin e katërt Kampion Bote më 2014-ën, kur një vit më parë Merkel kishte fituar e sigurt mandatin e saj të tretë si kancelare.

Tatëpjeta politike dhe futbolistike gjermane filloi në “Evropianin 2016”, kur kampionët e botës u larguan me turp, pikërisht atëherë kur ai ishte aq i nevojshëm për publikun dhe sidomos për politikën gjermane dhe Merkel, të cilët po gëlonin pas krizës së madhe të azilit dhe pohimit “Wir schaffen dass!” (Ne do t’ia dalim) kur kultura e mirëseardhjes filloi të zëvendësohej me gjuhën dhe aktet e urrejtjes, forcimin e populizmit dhe ekstremizmit, etj.

Kriza e vërtetë e futbollit dhe politikës gjermane u shfaq më dukshëm gjatë verës së këtij viti. Kampionët e botës 2014 në Rusi nuk mundën të shkonjë as në ndeshjet kualifikuese të grupit, kurse disa ditë më parë u mundën keqas nga holandezët modestë 3-0.

Po kështu, ndryshe nga sa jemi mësuar ta shohim, edhe Bajerni i famshëm ka disa ndeshje që po mundet dhe brenda Gjermanisë, duke rënë në krize. Ai i ka shtuar edhe më shumë “dhimbjet e kokës” për teknikun e Kombëtares, Lëv, sepse Bajerni është furnizuesi kryesor i Kombëtares gjermane.

Ashtu si futbollit, gjatë verës edhe koalicioni i madh qeveritar dhe Kancelarja Merkel u godit rëndë deri sa nuk mbante më, pas disa deklarimeve dhe qëndrimeve populiste dhe ekstremiste të lider-shipit të CSU-së. E megjithatë, në zgjedhjet lokale të 14 tetorit në Bavari, ajo ra në kuotën më të ulët të pasluftës, duke humbur shumicën absolute. Edhe aleatja tjetër e Merkel, SPD-ja ra në minimumin e vet historik me vetëm 10 për qind të votave, duke goditur rëndë besueshmërinë e koalicionit të madh, muaj pas krijimit të tij. Ishin pikërisht këto qëndrime që vlerësohen si më të dëmshmet dhe më të rrezikshmet në historikun e CDU/CSU, që e ndërlikuan në extremis “lëshimin para portës” së Merkel. Ndaj, edhe Hessen i vogël mund të kthehet në një “waterlo” politike/zgjedhore” për koalicionin qeveritar, Merkel dhe Gjermaninë.

Gjithsesi, si futbollit, por sidomos politika gjermane kanë treguar shpesh se dinë të ngrihen edhe mbi krizat më të vështira, madje duke i kthyer ato në mrekulli, ndaj ka jo pak që shprejnë në “Mrekullinë e Hessenit”.

Mesazhi i Ditës

# Arsyeja e vërtetë e shkarkimit të Xhafajt dhe emërimit të Lleshit

Nga Dritan Hila

(vijon nga faqja 1)

... jetë ministër i Brendshëm deri në momentin kur Rama do të ndërhet realisht i kërcënuar nga arrestimet e tij. Pyetjes sime, nëse do ta lejonin amerikanët, njeri i të cilëve Xhafaj është, iu përgjigj se SHBA-të prioritet kanë stabilitetin rajonal dhe vetëm në të tilla raste bëjnë ndërhyrje drastike, siç ishte Berisha në '97-ën. Nëse Rama nuk i prek këto ekuilibra jashtë vendit, brenda vendit, ata përqipen që të operojnë me të mundshmen.

Koha i dha të drejtë. Le të përqipemi me një analizë larg bu-dallallëqeve që gëlojnë në të tilla raste. Pas dorëzimit të vëllait tek autoritetet italiane, Xhafaj nuk ishte i kërcënuar ligjërisht. Ai vetë, pavarësisht thashethemeve të rrjetit, nuk ka qenë i akuzuar për trafik droge dhe pjesëmarrës direkt apo indirekt në trafikje. Çështja e vëllait të tij ishte me shumë një arsye morale sesa operationale. Politikisht, ai ishte njeriu më i besuar i amerikanëve dhe pastaj gjermanëve. Ndoshta për shkak të një qasjeje prej shtetari që Fatmir Xhafaj ka ndaj shtetit apo edhe të kompleksit për vëllanë e dënuar, ai ishte njeriu më intransigjent në luftën ndaj trafikëve. Jo vetëm kaq. Ai nuk shquhej për zbatues të urdhrave të Ramës dhe ca me shumë shkatërroi edhe rrjetin e Tahirit në polici. Arrestimet e fundit kishin mbledhur lakun në qafën e Vang-jush Dakos. Bashkiaku i Durrësit tashmë nuk ka nevojë për dëshmi të tjera që është peng i krimit të organizuar në Durrës. Por ai është edhe padrinoja i PS-së në atë qark. Dako menaxhon rrjetet, tenderët dhe është nuni i shumë emërimeve në ndërmarrjet fitimprurëse të shtetit. Sa për shembull, drejtori i OSSHE, një gjigant me 250 milionë euro buxhet investimesh, të cilat



jepen sipas qejfit, është beniamin i Dakos dhe kandidati i mundshëm për Bashkinë e Durrësit. Kapja e përgjimeve të fundit, ku Dako vinte qershinë mbi tortë për lidhjet e tij me krimin, paniku që e kishte zënë bashkiakun e Durrësit dhe frika e kryeministrit për arrestimin e beniaminit, e detyruan Ramën të shkarkonte ministrin e tij.

Zëvendësuesi i tij, gjeneral Lleshi është kandidati i duhur për

të zëvendësuar Xhafajn për dy arsye.

Së pari qetëson opozitën, pasi gjenerali në fjalë është edhe autor i planit për shpalljen e shtetrrëthimit pas 21 janarit. Pra, është njeri i afërt me enturazhin e PD-së.

Së dyti, ndal valën e arrestimeve që ka shpërthyer, ose e drejton në kah tjetër. Për këtë i ka të gjitha cilësitë: nuk merr vesh nga puna e policisë dhe është njeri i të

gjitha sezoneve dhe stinëve. Ajo që pritët është se, si do të reagojnë ndërkombëtarët dhe a do ta detyrojnë Ramën të vazhdojë arrestimet vertikalisht.

Pasi shkarkimi i Fatmir Xhafajt (duhet të jesh profan të mendosh se Xhafaj ka dhënë dorëheqjen), është një shenjë jo e mirë, për ata që shpresonin se policia vërtet nuk po merrej me gjoba parkimesh, por po godiste të fortët real të vendit.

## HOROSKOPI

### DASHI

Mos jini shumë seriozë dhe kryeneçë, pasi kjo ditë kërkon nga ju që të jeni më të lirshëm. Përqendrohuni në realizimin e një plani efikas për punën tuaj, pasi ky është një moment shumë i rëndësishëm për karrierën.

### DEMI

Konsultohuni më shumë për të shqyrtuar disa propozime që keni marrë së fundmi. Në çështjet e dashurisë mund të jeni më tolerant, sepse partneri ka nevojë për më shumë liri.

### BINJAKET

Kjo është periudha më e favorshme në dashuri, për shkak se do të keni mundësi që të shfaqni hapur ndjenjat tuaja. Sa u përket parave, sot mund të keni momente jo të mira.

### GAFORJA

Ditë e favorshme për investime në projekte të rëndësishme. Nëse po mendoni që të realizoni një udhëtim të largët, duhet ta shtyni për më vonë atë.

### LUANI

Energjia do të jetë në nivelin e duhur. Kjo do t'ju lejojë që të çoni përpara disa plane biznesi. Në dashuri ndjeni nevojën për të pasur afër një njeri të rëndësishëm.

### VIRGJERESHA

Mund të përfshiheni në një debat me një person që e keni konsideruar mik. Mos lejoni që një person i tretë të trazojë ujërat mes jush. Sa u përket parave, jeni i favorizuar.

### PESHORJA

Mund të merrni një propozim të ri për punë. Konsultohuni përpara se të merrni një vendim. Në dashuri, fati mund t'ju buzëqeshë duke krijuar një lidhje të re.

### AKREPI

Ditë me fat sa u përket parave. Mund të merrni një rritje rroge ose një promovim, gjë për të cilën keni investuar shumë. Në dashuri nuk i keni fort mirë punët.

### SHIGJETARI

Mos mënskruani marrëveshje për të cilat nuk jeni i sigurt se mund të funksionojnë. Në dashuri duhet t'i thoni gjërat troç, në mënyrë që të shmangni keqkuptimet.

### BRICJAPI

Po mendoni të bëni disa ndryshime në vendin e punës, por yjet nuk ju favorizojnë në këto momente. Mos e ndërmerrni këtë hap pa ndryshuar situatën!

### UJORI


Do të kaloni disa momente të vështira në vendin e punës. Disa pengesa artificiale mund t'ju bëjnë pesimistë për të ardhmen. Mos u dekurajoni dhe mos hiqni dorë nga planet tuaja.

### PESHQIT

Ditë e mirë për të qëndruar pranë familjes. Pushoni sa më shumë për të fituar energji të reja. Aktivitetet e lehta sportive këshillohen për të pasur një shëndet optimal.



**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

- Hari spiune.
- Janë toksike.
- Gjysmë arrest.
- Janë vende pa ne.
- Johanny i Donnie Brasco.
- Priten nga meridianë.
- Me të nxjerrin një letër.
- U verbua nga Askushi.
- Një britmë në arenë.
- Shkrimtari i J'accuse.
- Si moral.
- Nota e diapazonit.
- Me dies në një liturgji.
- Një mund të jetë edhe veprimi.
- Eshhtë e re pas Krishtit.
- Inicialet e Bergman aktore.
- Ai i trëndafilut është i Umberto Eco-s.
- Fise pa fe.

- Një provë zjarri.
  - Eshhtë mjeshtri me... baketë.
  - Digjen po nuk u zbuluan.
  - Igji të Lazio.
  - Kush del... mbështet.
  - Mund të jetë unik.
  - Ngrihen për atentate.
  - Janë fjetore në kazerma.
  - Altini mesfushor.
- VERTIKAL**
- Fillojnë matanë.
  - Një Hans artist dadaist.
  - Eshhtë mjet rrethanor lundrimi.
  - Eshhtë ënjtje.
  - Lumi i Elizit.
  - Fillojnë mpirjen.
  - Eshhtë e gjithë Hëna.
  - Eshhtë qetësues për neurozat.
  - Taylor aktore.
  - Daniel i Robinson Crusoe.

- Kështu janë skenat që mallëngjejnë.
- Eshhtë pjesë në skenë.
- Lëvizje Ekologjike Lokale.
- Përshkohej nga Leti.
- Eshhtë muzika më e... kollajtë.
- Grazia Cucinotta aktore.
- Veriu pa ekstreme.
- Janë tre në trickëll.
- Scola, regjisor italian.
- Kufizojnë një metër.
- Mbahet me inat.
- Mbyllin kurse.
- Ka një shpejtësi fantastike.
- Laik kur s'është ai.
- Një liqen i kripur.
- Një mund të jetë fetar.
- Eshhtë lloj papagalli.
- Në hyrje të sallës.
- Priten në skaje.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


- Janë lokale me kubiste.
- Me të nxjerrin në tapë.
- Polanski regjisor.
- Qeni i famshëm i Odiseut.
- Mbeten në fund.
- Gabon në ekstreme.
- Rreh në kufij.
- Eshhtë vepër për një... vepër.
- Janë udhëtime për një vend të shenjtë.
- Dinë shumë gjuhë.
- Një mendim.
- Famëkeqi Capone.
- Kush i kthen... të braktis.
- Kisha pa zë.
- I fjuari i kukullës Barbie.
- Ritet pa re.
- Një brinjë në skuadër.
- Emri i Zola.

**VERTIKAL**


- Barymore aktore.
- Tiriac që qe tenist.
- Ekstreme në studim.
- Eshhtë kleri me papën.
- Ndezur në aparaturë.
- Kaluar në krye.
- Janë racë e pastër.
- Një treg pa re.
- Duhen fituar me djersë.
- Një dritë për sake.
- Lëvizin pasi mendohen shumë.
- Janë sfera për bingo.
- Eshhtë më pak se nxehtësi.
- Gibson aktor.
- Tregonin shkelvër dikur.
- Mund të jenë fetare të tilla.
- Kush nuk ka... nuk i ecën.
- Një sherr në shtyp.
- Një lidhëz.
- Mund të jenë cigaresh.
- Mund të bëjë zoom.
- Ndërmarrje Industriale Mirditë.
- Pak konkrete.
- Eshhtë i mirë me shokë shumë.
- Artikull për shumë francezë.
- Kanto kur nuk... ka.
- Muzika me jam session.
- Mbyllin një sherr.
- Të fundit në sirtar.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

9	5	1	8	2					
6	7	1	3		9	8			
4			6	5		9			
5	9					7			
2	7								
			9				4	5	
			5					2	
3				1	6	4	9	8	
	9							3	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

6	8	7	4	5	1	9	3	2	
4	3	9	8	2	6	7	1	5	
5	2	1	9	3	7	4	6	8	
2	4	6	1	8	3	5	7	9	
7	9	5	6	4	2	1	8	3	
3	1	8	7	9	5	2	4	6	
8	7	2	5	6	4	3	9	1	
1	6	3	2	7	9	8	5	4	
9	5	4	3	1	8	6	2	7	

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

M	A	T	I	S	S	E	K	A	L	A	T	E
I	R	O	N	H	B	I	D	O	N	E	T	
A	O	P	E	R	A	A	L	E	T	I		
S	T	E	A	N	A	T	E	M	A	T		
K	P	E	L	I	K	A	N	I	A	T	A	
E	P	I	D	E	M	I	K	E	R	E	S	
D	O	R	O	T	E	A	A	L	B	E	R	T
I	L	M	T	M	I	E	T	A				
N	A	S	S	P	A	K	O	T	S	R		
A	K	T	U	A	L	I	T	E	T	I	A	
T	E	A	M	E	E	R	T	M	E	R	R	
T	R	A	G	E	T	I	A	I	D	A	N	
A	V	A	B	B	A	A	L	M	A	R		
P	U	A	M	A	R	E	T	A	T	A	R	
E	S	F	E	R	A	T	N	O	R	A		
L	A	T	L	P	O	T	I	M	I	A		
M	O	N	O	T	O	N	E	T	K	R	I	
S	A	L	D	O	R	A	O	N	E			
E	T	I	I	N	T	E	R	U	N	I		
N	O	T	I	E	I	N	R	I	I			
D	R	E	R	E	E	T	N	I	K	P		
E	A	S	I	A	O	M	E	R	A			
S	T	I	N	A	K	U	R	E	A	R		
P	M	I	T	E	T	E	S	T	E	T	I	

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**

*Argëtim filozofik*

- Kënaq me atë që ke, dhe lëri gjërat ashtu siç janë. Kur të kuptosh që s'mungon asgjë, e gjithë bota do të përkasë (Lao Tzu)
- Sa më shumë e mendoj aq më shumë e kuptoj që s'ka asgjë më artistike se sa të duash të tjerët (Vincent Van Gogh)
- A nuk është interesante se si jemi të gjithë të krijuar nga Zoti, dhe prapë dallojmë kaq shumë. (Desmond Tutu)
- Integriteti nuk ka nevojë për rregulla (Albert Camus)

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**

Përgjigja e numrit të djeshëm

9	1	2	4	16		17		18	V	O	T	6	A	V	A	P	E	N	I	V	O	D	K	A	
11	3	2	5	4	18	6		5	18	3	2			A	R	A	H	E	L	M	I	M	I	D	
9	6	9	9	10		2	18				2	1		T	I	P	E	R	I	O	D	I	K	A	
8	1		9	11	1	3	1	3	2	5	2	3		E	M	O	D	E	R	N	E	T	T	P	
17					1	3	2	6	1	8	2	6	1		R	E	I	D	I	O	A	O	T		
	7	4	10	3	2	6	12	3	1		14			P	P	A	R	A	D	A	A	T	R		
13	6	12	5	2	3	9	4	1		11	6	18		P	A	R	E	A	K	I	L	O	N	I	
14	6	2	4	9	1		4	10			1	12		R	A	S	T	E	D	E	N	I	R	O	
18	11		4	7	4		7	4	13		3			O	L	E	L	E	S	T	E	T	T		
2	6	7				3	1	10	6		2	2		V	H	I	E	N	A	E	N	T	O		
6	15	2	3	9	3		4	1	6	12	4	6		A	R	I	A	N	E	T	R	R	A	P	
16	5	12	3	7	4	13	6		9	3	6	1		T	E	R	R	I	T	O	R	D	E	T	I

*Thënie të mençura*

- Ajo që dimë është një pikë, ajo që nuk dimë është oqean (Isaac Newton)
- Shkenca pa fenë është e çalë, feja pa shkencën është e verbër (Albert Einstein)
- Njeriu ndjehet i frikësuar vetëm nëse nuk është në harmoni me veten (Hermann Hesse)
- Një shoqëri delesh me kohë lind një qeveri ujçerësh (Bertrand de Jouvenel)

